Dhuratë e revistës Etika
Vesë
Viti 3 • Numri 9 • Janar-Mars 2015
Ndonjëherë...

PROGRESI BOTIME

I RI



Arsyeja dhe Filozofia

Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË RINJ



SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: revistaetika@progresibotime.com

KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Vite më parë një i urtë qëndroi në rrugë dhe i tha njërit që po kalonte:

“Fytyra jote rrezaton dritë. Por zemrën e paske të mbyllur. Do të të shkruaj disa nga emrat e Allahut (xh.xh). Nëse i vazhdon këto për dyzet ditë, do të hapen sytë e zemrës.”

Pastaj i urti, ndërkohë që personi po e shikonte i habitur, i shkroi emrat në një letër dhe ia dha. Ka nga ata njerëz që mendojnë shumë. Edhe ai që mori letrën, tha me vete:

“Ore! Unë akoma nuk mund të duroj ato që më shohin sytë e ballit, si do të bëhet gjendja ime, nëse më hapen edhe sytë e zemrës?! Mos e thëntë Zoti, nuk më nxë më kjo botë, nuk mund të gjej edhe vend tjetër ku të shkoj dhe çmendem.”

Dhe e vendosi letrën diku. Aq sa edhe vetë e harroi se ku e la dheështu u mbyll çështja e hapjes së syve të zemrës. Por ç’të duhet ty, more i bekuar! Mos vallë Ai që të sjell ty në këtë gjendje nuk mund të të japë forcë të durosh?! Ai nuk e kishte kësmet, por nuk e mendoi këtë. Pas disa vitesh pashë se po ankohej e thoshte:

“Ah, ah... Nga ta dija se do të vinte një ditë dhe unë do të kërkoja të njihja zemrën e njerëzve me të cilët përballesha dhe këtë do ta kërkoja vetëm për t’u mbrojtur nga dëmet e tyre. Sikur të isha ky që jam sot, do t’i lexoja patjetër dyzet ditë ata emra... Nuk e di vallë, a do të vijë ai i urtë përsëri tek unë...”

I thashë:

“Në çdo gjë ka mirësi. La tahzen!”

VITI: III
NUMRI: 9
Janar-Mars
2015

BOTUESI
Shtëpia Botuese “Progresi”
DREJTOR
Albert Halili
KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj
PËRKTHYES
Ernida Kraja | Eva Kajti
Naile Sulaj
DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri
MOBILE
+355 67 607 8484
E-MAIL
rev.etika@gmail. com

Përmbajtja

A jeni gati për dimër? 38
Nejla Bash

Besimi kërkon dëshmi 20
Osman Nuri Topbash

Të gjithë mashtrimet janë pretekste 8
Fatma H. Liman

Kam nevojë... 18
Kubra Çoban

O Allah! Ndihmoje njeriun që nuk ka frikë nga farfëria 30
Hatixhe Kubra

Së pari të tradhëton syri 5
Halime Demireshik

Profeti im mësues 23
Shefika Kaja Meriç

A kam aftësi sipërmarrëse? 33
Flutura Ura

Ndonjëherë 12
Neslihan Nur Turk

Çdo njeri mund të ndihmojë 26
Elif Menxhet

Pasuria nuk është gjithmonë bekim 34
Fatma Allada

A bëjmë kujdes ndaj hakut të robit? 16
Seher Ajdën

Receta gatimi 29
Rushan Kavallë

Ushqyerja artificiale 36
Dr. Betyl Inall

SYRI SË PARI TË TRADHËTON

Halime Demireshik

Allahu i Madhëruar thotë:

"Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por në të vërtetë mashtrojnë vetëm vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë." (Bekare, 9)

Vitin e kaluar mora një letër të gjatë nga një lexuesja ime. Lexuesja kishte lexuar librin tim me titull "Nënat e besimtarëve" dhe kishte shkruar një letër kritikuese për librin. Në letrën e saj thoshte:

"...Edhe ju jeni si fetarët e tjerë. Në pjesën e librit prej së cilës merret mësim, keni theksuar se meshkujt gjithmonë kanë të drejtë. Në të vërtetë nuk është ashtu. Në shumicën e rasteve, gratë janë ato që kanë të drejtë!.." Pastaj, ato që i kishin ndodhur, i kishte shkruar gjatë e gjatë me të gjitha detajet, në letrën që e kishte lagur me lot:

"Unë u martova me burrin tim duke menduar se ishte fetar. Sepse unë jam rritur me imponimin e mendimit se burri fetar është një njeri i ndërgjegjshëm dhe i dhënë pas shtëpisë, bashkëshortes e fëmijëve të tij. Gjendja financiare e burrit tim është e mirë dhe ai vetë është një zotëri i arsimuar... Edhe unë jam një zonjë e bukur, që mund të dallohem ndërmjet moshatareve të mia, e mbaj veten mirë dhe jam e arsimuar.

Kur u martuam, ishim shumë të lumtur. Për këtë arsye, i bindesha bashkëshortit tim për çdo gjë që donte, sepse me të vërtetë e doja shumë atë dhe akoma e dua shumë. Para se ai të vinte në shtëpi, shtëpia ishte e pastruar, vetë vishesha bukur dhe ushqimin e përgatisja sikur po prisnim ndonjë mysafir. Kur na lindën fëmijët, lumturia jonë pothuajse u shtua edhe më shumë.

Një ditë, kur po qëndroja me disa shoqe, disa prej tyre më thanë në mënyrë indirekte:

-Hapi sytë! Burri yt nuk është aq i sinqertë siç e mendon ti!

Së pari u thashë:

-Jo! Burri im ka frikë Allahun!

Por në zemrën time lindi dyshimi... Pas një hetimi të vogël, mësova se burri im më mashtronte me të vërtetë. Zemra m'u mbush me urrejtje. Ky nuk mund të ishte burri im. Këtë nuk mund t'ia bënte një gruaje si unë, që e donte kaq shumë. Veten e ndjeja fajtore dhe thosha: Çfarë gabimi kam bërë, që burri im ka rënë në haram? Qava për ditë të tëra. Së pari hetova gruan me të cilën shkonte.

A ishte më e bukur se unë? Sepse, sa herë që shikoja pasqyrën, e ndjeja veten të shëmtuar. Mendoja: sikur të jem e bukur, nuk do të më tradhtonte. Pastaj pështyja pasqyrën. Kur e pashë atë grua, sikur u gëzova, sepse nuk ishte aspak e bukur.

Ndërkohë që vazhdoja ta hetoja, pashë se ajo grua nuk kishte asnjë gjë që ta bënte më të mirë dhe më tërheqëse se unë. E mblodha veten, e mora burrin përballë dhe e pyeta: Përse më ke tradhtuar? Në fillim e mohoi, por pastaj e pranoi dhe tha:

"Vetëm jam argëtuar me të. Ishte thjeshtë një dëshirë e përkohshme!" Gjaku më hipi në tru. Burri u mundua të më qetësonte, duke më thënë:

-Ti je një grua e mirë. Unë e kuptoj se kam qenë njeri me shumë

fat që jam martuar me ty!" Nuk mendonte aspak të divorcohej. Faktikisht, as unë nuk mendoj, por nuk mund ta fal në asnjë lloj mënyre. Ju lutem! Me tregoni një rrugëzgjidhje!..."

Javën e kaluar telefonoi një grua që e njihja me të vërtetë:

"Burrin tim nuk po e ngre dot nga kompjuteri. Ai gjithmonë bisedon me gra të huaja, që kanë emra të ndryshëm!.." Edhe ajo i kuptonte përgjegjësitë e saj. Ajo është një grua e zgjuar dhe dëshira e vetme e saj është që burri t'i shpëtojë nga ajo sëmundje...

Jam e sigurt se shumë lexues që do ta lexojnë këtë shkrim, do të mendojnë: "Kush e di se çfarë i ka thënë burrit dhe e ka ftohur nga shtëpia!" Apo: "Çfarë detyre mund të ketë neglizhuar, që burri i saj ka rënë në haram!"

Sigurisht që ka edhe të tillë, madje këta mund të jenë shumica dërmuese. Por të mos harrojmë se ka edhe raste të veçanta. Ka shumë gra të mrekullueshme që dërmohen nën këtë sprovë të vështirë. Unë them se duhet të mendojmë para se të gjykojmë.

Le të shohim sot nga dritarja e një gruaje që e tradhton burri... Lëreni pabesinë e pandershmërinë dhe të fillojmë nga udhëtimi drejt haramit, që sot syri bën në gjëra të cilat duken të vogla. Çfarë ndjen një grua kur e shikon burrin e saj duke parë në haram? Disa përgjigjen:

"Bëhet xheloze!.."

Jo! Nuk bëhet xheloze, por lëndohet, preket dhe zhgënjehet kundrejt njeriut që e donte më shumë. A nuk është zina dhe tradhti e syrit drejtimi i tij në haram? A nuk është tradhtia një shkatërrim ndjenjash dhe një depresion, që në fillim çdo grua e ndjen veten të pamjaftueshme dhe të shëmtuar duke u zemëruar me pasqyrën? Sepse, si një grua fetare, ajo nuk e ka hedhur syrin në haram. Ajo është përpjekur për ta ruajtur nderin dhe moralin e saj. A është e tepërt që të njëjtën ndjesi ta presë nga burri i saj?

Gjithmonë më ka bërë përshtypje ajeti i tridhjetë i sures Nur, që njofton për urdhrin e mbulesës në Islam. Allahu (xh.sh), në ajetin fisnik, thotë:

"Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre *(nga e ndaluara)* ***dhe ta ruajnë nderin e tyre*** *(nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)****! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për atë që bëjnë ata."*** (Nur, 30)

Sa ajet i hapur dhe i qartë, apo jo? Sikur ka zbritur për ditët e sotme...

Do të thotë se mbulesa më e rëndësishme e burrit është mbrojtja e syve... Kur mbrohen sytë, mbrohet edhe nderi. Domethënë, njëra nga rrugët që të çon në haram, me mbulimin e syrit, mbyllet. Ndërsa paralajmërimi në pjesën e fundit të ajetit është në një shkallë sigurie për çdo ndërgjegje...

"Padyshim Allahu është në dijeni për çdo gjë që ata veprojnë."

Pra, mos u frikëso nga shokët e miqtë, por frikësoju Allahut!.. Dhe mos harro se mund të fshihesh nga të gjithë, mund t'i mashtrosh të gjithë, por Allahun nuk mund ta mashtrosh...

Në vijimin e të njëjtit ajet (Nur, 31), u urdhërohet grave mbulesa. Në këtë ajet nuk tregohet menjëherë mënyra e të mbuluarit; së pari gratë urdhërohen që t'u lëshojnë syve një perde mbulese:

"Thuaju grave besimtare t'i mbrojnë sytë e tyre nga harami..."

Do të thotë se mëkati nuk ka gjini! Mbrojtja e syrit nga harami, largimi nga çdo veprim dhe aludim që mund të bëhet shkak për zina (imoralitet), është farz (obligim) edhe për gruan, edhe për burrin.

Ta shohim këtë çështje edhe nga jeta e Pejgamberit, (a.s), i cila është "usve-i hasene" (shembulli më i bukur):

Fazli, djali i Abbasit, xhaxhait të Pejgamberit, (a.s), ishte një djalosh i pashëm me fytyrë të bukur e lëkurë të bardhë. Ai nuk u nda nga Pejgamberi, (a.s), gjatë haxhit të lamtumirës dhe ditën e dytë të Kurban Bajramit shkoi bashkë me të (a.s), në Mina për të gjuajtur me gurë shejtanin. Ndërkohë, te Pejgamberi, (a.s), erdhi një grua e re dhe e bukur. Ajo e pyeti:

"O i Dërguari i Allahut! Babai im është shumë i moshuar dhe nuk është në gjendje të qëndrojë mbi deve... Edhe në këtë gjendje e ka farz haxhin. A është e lejuar, nëse unë e bëj haxhin në vend të tij?"

Pejgamberi, (a.s), i tha:

"Po, mund ta bësh haxhin në vend të babait."

Ndërkohë, Fazli ia kishte ngulur sytë gruas së re dhe po e shikonte. Pejgamberi, (a.s), e kapi nga koka, ia ktheu në anën tjetër dhe e këshilloi:

"O Kushëri!.. Sot është dita kur njeriu duhet ta zotërojë veshin, syrin dhe gjuhën; është dita që të falen të gjitha mëkatet. Vepro ashtu si duhet..."

Babai i Fazlit i kishte parë ato që ndodhën mes Fazlit dhe Pejgamberit, (a.s). Ai e pyeti Pejgamberin

(a.s):

"O i Dërguari i Allahut!.. Përse ia ktheve fytyrën kushëririt tënd?"

Pejgamberi, (a.s) i tha:

"Pashë shikimin e një djali me një vajzë dhe u frikësova se mos shejtani hyn mes tyre."

Përsëri i Dërguari i Allahut e këshilloi Aliun, i cili ishte rritur nën edukimin e tij (a.s), duke i thënë:

"O Ali, mos i shto shikimit shikim!.. I pari është shikimi yt, të tjerët janë prej shejtanit!.."

Për fat të keq, sot ekziston një grup njerëzish që madje tashmë nuk e quajnë as mëkat shikimin dhe që thonë: "E kam zemrën të pastër". Por këta që thonë këtë, duhet të mendojnë, - Allahu na ruajtë- a nuk e kishte të pastër zemrën Aliu?

Përsëri, çfarë duhet të thonë ata që e xhelozojnë bashkëshorten e i thonë:

"Mos shko atje, mos shiko atë!", ndërsa vetë sillen pa e vrarë mendjen?! Përkundrazi, nëse duam që bashkëshortet tona të jenë besnike, së pari duhet të peshojmë besnikërinë tonë.

Pejgamberi, (a.s), çdo fjalë e të cilit është bërë shërim për njerëzimin, që burrat të mos bien në këtë gjendje të keqe, u bën thirrje atyre:

"Jini të pastër e të ndershëm, që edhe gratë tuaja të jenë të moralshme, të ruajnë nderin dhe të mos e humbin dinjitetin." (Keshfu'l-Hafa, H, Nr: 1738)

Ta kurorëzojmë këtë hadith fisnik me një ajet:

"O ju që keni besuar, përse thoni atë që nuk e bëni?" (Saff, 2)

Të mos harrojmë se ekziston një hallall, që e pengon çdo haram.

Pejgamberi, (a.s), thotë:

"Nëse bashkëshortët e shikojnë njëri- tjetrin me dashuri, edhe Allahu i shikon ata me syrin e mëshirës; nëse kapen dorë për dore, u bien mëkatet nga mesi i gishtërinjve."

Ndërsa, në hadithin vijues thotë për të kundërtën e këtij shikimi se në ahiret do të jetë "shkak për ndëshkim".

"Kush e shikon një grua të huaj me sy të keq, në Ahiret do t'i hidhet në sy plumb i shkrirë." (Sherhu Fethu'l-Kadir, VIII, 97)

Pejgamberi, (a.s), në një hadith tjetër fisnik ka thënë:

"Djem! Martohuni! Sepse martesa ju mbron nga harami i syve." (Tirmidhi, Nikah, 1, H, Nr: 1081)

Allahu e bëftë martesën tonë një pengesë për haramet! Allahu na e ruajtë syrin dhe zemrën nga haramet! Amin.

LE TË SHOHIM SOT NGA DRITARJA E NJË GRUAJE QË E TRADHTON BURRI... LËRENI PABESINË E PANDERSHMËRINË DHE TË FILLOJMË NGA UDHËTIMI DREJT HARAMIT, QË SOT SYRI BËN NË GJËRA TË CILAT DUKEN TË VOGLA. ÇFARË NDJEN NJË GRUA KUR E SHIKON BURRIN E SAJ DUKE PARË NË HARAM?

TË GJITHË MASHTRIMET JANË PRETEKSTE

Fatma H. Liman

Supozojmë se vëllai ynë i madh ka gënjyer babain dhe e ka kaluar në emrin e tij tapinë e dyqanit që i përkiste babait. Është koha e trashëgimisë dhe papritur shikojmë se babai nuk ka asnjë pasuri dhe ne nuk na ka ngelur asgjë nga trashëgimia. Vëllai na ka mashtruar.

E zëmë se tregtari na e ka shitur një mall 3-lekësh për pesë lekë. Tregtari na ka mashtruar.

Supozojmë se një shitës i pronave të patundshme na e ka lavdëruar shumë një shtëpi me shumë probleme; edhe ne, duke i besuar atij, e kemi blerë. Pas kësaj kemi bërë një sërë harxhimesh dhe e kemi dëmtuar shumë buxhetin familjar. Shitësi na ka mashtruar.

Supozojmë se bashkëshorti që e duam shumë, nuk na ka thënë të vërtetën në mënyrë të drejtë që në fillim dhe na ka tradhtuar me një njeri që i besonim shumë. Bashkëshorti na mashtroi.

E zëmë se gruas sonë nuk i pëlqen rroga që marrim; i dukemi të pamjaftueshëm dhe pa karrierë, sipas saj qenkemi edhe të shëmtuar... Të gjitha këto janë bashkuar; ajo ia ka mbathur me shokun e saj të punës dhe na ka braktisur. Pra gruaja na ka mashtruar.

Me të gjitha këto ndodhi, ne jemi mashtruar materialisht e shpirtërisht dhe jemi dëmtuar shumë. Jo vetëm jemi dëmtuar, por na është tronditur edhe besimi, na është lënduar edhe zemra.

Supozojmë se kemi kërkuar nga shtëpia e botimit të bënim përkthimin e një vepre të vyer Osmane dhe ata ta botonin atë vepër. Ndërsa shtëpia botuese na falënderon me delikatesë dhe na thotë:

“Zotërinj, kjo vepër nuk shitet dhe ne dalim me humbje. Ju falënderojmë për propozimin!”

Ne kthehemi të mërzitur. Por pas disa muajsh shohim se ata, veprën për të cilën thanë se nuk shitej, ia kanë dhënë dikujt tjetër për ta përkthyer dhe kanë bërë botimin e dhjetë. Pra vepra ishte një vepër me të vërtetë cilësore për t'u shitur. Shtëpia botuese na e vodhi mendimin, na bëri të hiqnim dorë dhe na mashtroi bukur.

E zëmë se fëmija ynë ka dalë nga shtëpia duke na thënë se shkon në kurs, por ka shëtitur me shokët në Bejogllu e në rrugën Istiklal dhe është argëtuar me paratë të cilat gjoja i kishte marrë për të blerë librin e testit. Fëmija ynë na mashtroi.

Supozojmë se djali ynë i martuar na ka marrë mijëra lira duke na thënë:

"Nuk munda ta paguaja borxhin e kartës së kreditit dhe banka do të më vijë në shtëpi për sekuestrim!.." dhe këtë e ka bërë disa herë duke abuzuar me nijetin tonë të mirë dhe duke na shkaktuar shumë humbje. Në këtë mënyrë, u ka hyrë në hak edhe vëllezërve të tij. Pastaj mësojmë se ai luante bixhoz dhe ne paguanim borxhin e tij të bixhozit.

Pra, djali ynë i martuar e me familje luante me ne, na mashtronte. Sa e dhimbshme! Sa e sa herë na kishte mashtruar djali ynë pa e ndjerë.

Supozojmë se kemi dy vajza dhe një djalë. Djali na thotë:

"Nëse më jep tapinë e shtëpisë, do të kujdesem për ty." Edhe ne ia japim tapinë. Sapo e merr, thotë:

"Ti nuk po kalon mirë me gruan time, do të më prishësh familjen. Shko, të kujdesen motrat e mia për ty!.." dhe të lë në mes të rrugës. Ndërsa të gjithëve u thotë se jemi shumë grindavecë e kokëfortë dhe se nuses së tij nuk i janë tharë lotët prej vuajtjeve që heq nga ne. Djali ynë shpifi për ne dhe na mashtroi!..

Nëse i vlerësojmë një e nga një ngjarjet e mësipërme, mund të themi:

"Ai që mashtron është mizor, ai që mashtrohet është i pafajshëm!"

"Mashtruesi ka mendime djallëzore, ai që mashtrohet është nijetmirë dhe i pastër."

Thonë: "Ai që mashtron të tjerët, në fakt mashtron veten.", por a është me të vërtetë ngjarja ashtu siç thuhet?"

"Në të vërtetë, a ka gjuajtur gjahtari që shkon për gjueti? Gjuetari paska gjuajtur dhe të gjithë kaprojtë e thëllëzat i paskan shkuar nga pas duke i qeshur?"

A kështu t'i vlerësojmë të gjitha ngjarjet e të mashtruarit dhe mashtrimit? Apo ka prej tyre që duhet të trajtohen ndryshe? A nuk duhet ta ndajmë shapin nga sheqeri? Kam dëgjuar nga njëri:

"Nuk ka mashtrim, ka besim. Njeriun e mashtron ai që i beson më shumë." A mund të jetë e vërtetë kjo?

Çështja e mashtrimit është një çështje e vjetër sa vetë njerëzimi. Fatkeqësia e parë që i ndodhi njeriut ishte "ngjarja kur ai u mashtrua nga djalli i mallkuar"...

Ademi e pa me sytë e tij xhenetin dhe xhehenemin. Ai ishte një pejgamber që e pa nga afër madhështinë e fuqinë e Allahut dhe qe dëshmitar për këtë... Ai ishte një pejgamber që dëshmoi besimin, dashurinë dhe vlerën që ia dha Allahu i Madhëruar, duke i bërë sexhde engjëjt vazhdimisht...

Allahu i Madhëruar, që e vlerësonte kaq shumë Ademin, ia ndaloi atij dhe gruas së tij veçanërisht ngrënien e frutit të një peme. Ademi dëgjoi krahasimin e djallit të mallkuar, të paaftë e të shkretë duke iu bindur vesvesit e mashtrimit të tij. Ai nuk dëgjoi autoritetin e lartë, pra, fjalën e Allahut të Lartësuar i Cili nuk ka ortak në gjykimin e Tij. Një pejgamber i cili i pa nga kaq afër çdo gjë, a mund të thotë:

"Nuk pata asnjë faj, më mashtroi djalli!.."

Të dëgjuarit nga ai fjalën e shejtanit, kur e dinte forcën dhe fuqinë e Allahut dhe ndërkohë që posedonte gradat ilme'l-jakin, ajne'l-jakin, hakka'l-jakin, Allahu Teala në suren Bekare, ajeti 145 e shpjegon:

"Nëse ti, pasi të është zbritur dituria, do të ndiqje dëshirat e tyre, atëherë pa dyshim që do të ishe një nga keqbërësit."

Për këtë arsye, Ademi dhe gruaja e tij e nderuar iu lutën Allahut:

Ata thanë: "O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit" (A'raf, 23)

Domethënë, nuk është e vlefshme në çdo kohë dhe në çdo vend fjala e urtë: "Ai që mashtron, mashtrohet."

Në të vërtetë, a i mashtron djalli të gjithë? A është ai kaq i fortë? A janë të paaftë dhe të dobët njerëzit përpara mashtrimit të tij?

Iblisi tha: "Zoti im, për shkak se më çove në humbje, unë do t'ju zbukuroj atyre *(njerëzve)* ***rrugën e gabuar në tokë dhe të gjithë do t'i shpie në mashtrim, përveç robërve të Tu të sinqertë"*** (Hixhr, 39-40)

Në ajetin vijues tregohet qartë se robërit e sinqertë të Allahut nuk do të dëmtohen nga shejtani:

(Allahu) ***tha: "Kjo është rruga Ime e drejtë. Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty."*** (Hixhr, 41-42)

Ne e dimë dhe besojmë se Allahu Teala nuk gënjen. Të gjitha që thotë janë të vërteta. Atëherë, djalli kurrë nuk mund t'i mashtrojë njerëzit e devotshëm.

Mashtrimi i vëllait në trashëgimi, mashtrimi i tregtarit, mashtrimi i shitësit të pronave të patundshme, të gjitha këto me të vërtetë hyjnë te dispozita e hadithit fisnik *"Ai që mashtron, nuk është prej nesh."*

Pejgamberi, (a.s), pas një dite me shi, del të kontro-

llojë tregun e Medines. Ndalon përpara një tezgjahu dhe e fut dorën në thesin me mall, i cili ishte lagur gjatë shiut dhe pjesa e sipërme ishte tharë në diell. Kur e futi dorën, iu lagën gishtat. Për këtë arsye e pyet shitësin:

"Ç'është kjo lagështi?"

Shitësi i thotë:

"O i Dërguari i Allahut! E ka lagur shiu." Pejgamberi, (a.s), i tha:

"Ta kishe nxjerrë sipër pjesën e lagur, që njerëzit ta shikonin e të mos mashtroheshin!. Ai që na mashtron, nuk është prej nesh." (Muslim, Iman, 164)

Nëse mashtrohemi me fjalët e një njeriu autoritar për një çështje në fushën e së cilës nuk kemi dije, ky është mashtrim me kuptimin e vërtetë të fjalës. Ata që na mashtrojnë në këtë mënyrë, nuk janë prej nesh. Nëse e vërejmë me kujdes hadithin fisnik, shohim një veprim shumë interesant të Pejgamberit, (a.s); zhytjen e dorës në thesin me mall dhe kontrollin për lagështinë e produktit...

Ja, edhe ky "veprim i kontrollit" është sunet. Domethënë të kërkosh, të zhysësh dorën dhe të mundohesh të kuptosh të vërtetën e çështjes... Nëse, edhe pse kemi marrë masa, përsëri jemi mashtruar, atëherë mund të hyjmë në brendësinë e këtij hadithi fisnik dhe menjëherë në ndihmë na vijnë ajetet:

"Por, nëse ata synojnë të të mashtrojnë, të mjafton Allahu *(si mbrojtës)*. ***Ai të ka forcuar me ndihmën e Tij dhe me besimtarët."*** (Enfal, 62)

"Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por në të vërtetë, mashtrojnë vetëm vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë." (Bekare, 9)

Mashtrimi i gruas, mashtrimi i fëmijës, mashtrimi i më të dashurve tanë, është një goditje që na vjen nga njerëzit më të besueshëm dhe hyn në një pjesë të ndryshme të mashtrimit. Të thuash "Nuk ka mashtrim, ka besim." është një shprehje e pamjaftueshme…

Çfarë është kjo gjë që quhet "besim", në një kohë kur njeriu nuk duhet t'i besojë as vetes, në një kohë kur vetja nuk e meriton kurrë që t'i besohet dhe kur njeriu duhet të jetë ndërmjet "haufit/frikës" e "raxhesë/shpresës" dhe ta shikojë jetën nga ai këndvështrim!..

Fëmija ynë nuk është engjëll, as bashkëshorti nuk është dhe as ne nuk jemi. Asnjëri prej nesh nuk është i përsosur. Faktikisht, çdo njeri vazhdimisht na tregon se kush është... Edhe fëmija, edhe bashkëshorti ynë. Ne e dimë se çfarë natyre kemi të gjithë, por nuk duam ta pranojmë.

Ne mendojmë: "Fëmija ynë është fëmija më i drejtë, më i sinqertë." Në fakt, nuk është fëmija që na mashtron, jemi ne që mashtrojmë veten.

Themi: "Gruaja ime është shumë besnike". Por duke harruar përbindëshin që njeriu ka brenda vetes, pra nefsin, në fakt mashtrojmë veten, sepse në nefsin e çdo njeriu ekziston potenciali për të "mashtruar". Allahu, xhelle xhelaluh, na ndihmoftë dhe na dhëntë mirësi! Ndërkohë që njeriu nuk duhet t'i besojë qoftë edhe nefsit të tij, si mund t'i besojë nefsit të bashkëshortit (bashkëshortes), fëmijës dhe vëllait (motrës)?

Në ajetet 14-15 të sures Tegabun thuhet:

"O ju që keni besuar! Në të vërtetë, ju keni armiq në radhët e grave tuaja dhe të fëmijëve tuaj, andaj ruajuni prej tyre! Por, nëse nuk i vini re fyerjet e tyre dhe ua falni, ta dini se Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë. Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju. Allahu ka shpërblim të madh."

Çdo ngjarje ka mundësi t'i ndodhë çdo njeriu. Ne nuk jemi robër të veçantë të Allahut, prandaj me të vërtetë mund të bëhemi pasues të një sprove të tillë. Askush nuk dëshiron të mashtrohet.

Kur punoja në Departamentin e Fetvave në Myftininë e Stambollit, një grua më tha:

"Kopshtin e trëndafilave e kishte mbuluar bari i egër, për shkak se nuk ishte kujdesur mirë për të." Domethënë, e kishte tradhtuar bashkëshorti.

"E di! Edhe unë kam neglizhuar në disa aspekte. Pasi u martova, mendova se çdo gjë është në rregull. Kështu që i besova vetes sime duke e pandehur burrin si pronën time me tapi. Por jo. Në çdo çast të jetës, paska qenë e nevojshme të jetoja në botën e një ndjenje ndërmjet frikës dhe shpresës."

Kishte shumë të drejtë. Asaj i kishte mësuar shumë gjëra mendimi në lidhje me ndodhinë që kishte përjetuar dhe analizimi në mënyrë objektive. Ato që tha, ishin shumë të vërteta. Pra, jo një "raxhe/shpresë" duke besuar verbërisht dhe duke menduar se nuk më mashtron, por as edhe një "hauf/frikë" që na e bën jetën zeher duke menduar se ky njeri do të më mashtrojë patjetër. Ne duhet të jetojmë ndërmjet "haufit" dhe "raxhesë"...

Zonja në telefon, më tha edhe këtë:

"Çdonjëri mund ta mashtrojë tjetrin, madje edhe bashkëshorti... Por Allahu Teala nuk na mashtron kurrë. Unë tani i besoj Allahut me një besim shumë të madh dhe nuk besoj se ka mik tjetër përveç Tij. As fëmija, as prindërit, as bashkëshorti... Vetëm Allahu është mik."

Bëmë me të një bisedë shumë kuptimplote dhe mësimdhënëse, falënderuar qoftë Allahu (xh.xh)... Siç thuhet edhe në Kuranin Famëlartë:

"Ndëshkimit të Tij nuk mund t'i shpëtoni as në tokë e as në qiell dhe përveç Allahut, nuk keni as mbrojtës, as ndihmës." (Ankebut, 22)

"Ata nuk mund të të mbrojnë aspak nga zemërimi i Allahut. Pa dyshim, keqbërësit kanë për mbrojtës njëri-tjetrin, kurse Allahu është Mbrojtësi i atyre që i

frikësohen Atij e që ruhen nga gjynahet." (Xhathie, 19)

"Njëmend, Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i tokës. Ai e jep jetën dhe vdekjen. Përveç Allahut, ju nuk keni tjetër mbrojtës apo përkrahës." (Teube, 116)

"Allahu i di më së miri armiqtë tuaj. Allahu mjafton si Mbrojtës për ju. Allahu mjafton si Ndihmës për ju." (Nisa, 45)

"Allahu është Ai që ka krijuar qiejt, tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre për gjashtë ditë, pastaj është ngritur mbi Fron. Ju nuk keni as ndihmës dhe as ndërmjetësues tjetër përveç Atij. Vallë, a nuk po vini vesh?" (Sexhde, 4)

Na mashtrojnë apo jo njerëzit, nuk ka rëndësi. E vërteta është se këto lloj mashtrimesh nuk janë asgjë. Rëndësi ka që ne të mos mashtrohemi pas kësaj bote dhe të mos shfaqim neglizhencë kundrejt Allahut, sepse rreziku më i madh, madje më i madh se rreziku nga mashtrimi i bashkëshortit, fëmijës, vëllait, është interesimi i njeriut për këto, neglizhimi kundrejt Allahut dhe adhurimit ndaj Tij.

"Ata të cilët e morën fenë për lojë e argëtim dhe u mashtruan nga jeta e kësaj bote, Ne sot do t'i harrojmë ashtu siç e patën harruar ata takimin e kësaj Dite dhe siç mohuan shpalljet Tona." (Araf, 51)

"O njeri! Çfarë të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd Bujar?" (Infitar, 6)

"O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është e vërtetë, prandaj, të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë djalli për Allahun." (Fatir, 5)

Qëllimi i ardhjes sonë në këtë botë është të adhurojmë Allahun (xh.xh). Martesa dhe fëmijët janë shërbimi për të arritur qëllimin e vërtetë. Harrimi i qëllimit të vërtetë dhe konsumimi i jetës sonë të shkurtër me çështje si bashkëshorti, fëmija, pasuria, trashëgimia, vëllezërit etj., nuk është gjë tjetër veçse mashtrimi më i madh.

Nëse djalli nuk mund t'i afrohet njeriut të sinqertë, neve na takon të përpiqemi për t'u bërë robër të devotshëm dhe të sinqertë ashtu siç e meriton Allahun Teala. Sinqeritet do të thotë: "Çfarëdo pune që të bëjmë, ta bëjmë sikur e shikojmë Allahun, ta dimë se Allahu është në dijeni për çdo gjë që bëjmë ne dhe të kërkojmë vetëm kënaqësinë e Allahut Teala në çdo punë që të bëjmë.

A ua vë veshin njeriu mashtrimeve të kësaj bote, nëse e zbaton në jetë fjalën:

"Ilahi, ente maksudi ve rizake matlubi", domethënë, "O Zot! Ti je synimi im. Ajo që kërkoj unë, është kënaqësia jote"... Sepse ky njeri kërkon një vlerë shumë më të lartë. A e humb Allahu atë që është lidhur me Të, që i lutet e që e do kaq shumë? Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik:

"Kush i dorëzohet Allahut, me tërë qenien e tij, duke qenë punëmirë, ai është kapur për vegën më të fortë. Tek Allahu do të kthehet çdo gjë." (Lukman, 22)

"Allahu i di të fshehtat e qiejve dhe të Tokës dhe çdo gjë kthehet tek Ai. Lutju Atij dhe mbështetu tek Ai! Zoti yt nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që bëni ju." (Hud, 123)

Atëherë, të lutemi me gjithë zemër dhe në çdo çast të jetës pa neglizhuar:

Thuaj: "Në të vërtetë, namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve." (En'am, 162)

Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s), thotë: *"Edhe sytë bëjnë zina (imoralitet). Zinaja e syve është shikimi me epsh."* (Ebu Davud, Nikah, 44)

Neslihan Nur Turk

Ndonjëherë

Më tha: “Ki frikë, është vetëtimë dhe ndonjëherë ka forcë të shkatërrojë!”

I thashë: “Por është edhe prijëse e mëshirës, la tahzen!”

Por njeriu ndonjëherë dëshiroka të dijë të fshehtën...

Vite më parë një i urtë qëndroi në rrugë dhe i tha njërit që po kalonte:

“Fytyra jote rrezaton dritë. Por zemrën e paske të mbyllur. Do të të shkruaj disa nga emrat e Allahut (xh.xh). Nëse i vazhdon këto për dyzet ditë, do të të hapen sytë e zemrës.”

Pastaj i urti, ndërkohë që personi po e shikonte i habitur, i shkroi emrat në një letër dhe ia dha. Ka nga ata njerëz që mendojnë shumë. Edhe ai që mori letrën, tha me vete:

“Ore! Unë akoma nuk mund të duroj ato që më shohin sytë e ballit, si do të bëhet gjendja ime, nëse më hapen edhe sytë e zemrës?! Mos e thëntë Zoti, nuk më nxë më kjo botë, nuk mund të gjej edhe vend tjetër ku të shkoj dhe çmendem.”

Dhe e vendosi letrën diku. Aq sa edhe vetë e harroi se ku e la dhe kështu u mbyll çështja e hapjes së syve të zemrës. Por ç’të duhet ty, more i bekuar! Mos vallë Ai që të sjell ty në këtë gjendje nuk mund të të japë forcë të durosh?! Ai nuk e kishte kësmet, por nuk e mendoi këtë. Pas disa vitesh pashë se po ankohej e thoshte:

“Ah, ah... Nga ta dija se do të vinte një ditë dhe unë do të kërkoja të njihja zemrën e njerëzve me të cilët përballesha dhe këtë do ta kërkoja vetëm për t’u mbrojtur nga dëmet e tyre. Sikur të isha ky që jam sot, do t’i lexoja patjetër dyzet ditë ata emra... Nuk e di vallë, a do të vijë ai i urtë përsëri tek unë...”

I thashë:

“Në çdo gjë ka mirësi. La tahzen!”

Por ndonjëherë dhëmbi e përtyp edhe halën...

Më tha:

“Ç’rëndësi ka, nëse tani iki e mundohem të shpëtoj... Shijet e hidhura më janë futur një herë deri në qeliza. Vetëm nga fytyra dhe fjalët e bukura, m’u hapën plagë shumë të dhimbshme dhe të

thella. Plaga e ka zakon të zërë cipë pak pasi dhemb. A ngelet shenjë? Po, ngelet dhe ajo shenjë do të jetë për mua përkujtuese, nëse unë nesër përsëri harroj të marr masa. Pastaj nuk duhet të fiksohem pas çdo ngjarjeje siç ngjitet çakëlli pas gurit. Nuk duhet t'i jap përparësi halës, por, nëse nevojitet, duhet ta ha peshkun bashkë me hala! Çfarë ndodh më tepër! Do të më dhembë më shumë, do të gjakosem pak; në fund bëhet shëndet!

Kam të drejtë nëse të thërras tani: "O peshk, që nuk munda të të hedh në zjarr dhe nuk pata zemër të të pjek me kohë, që të mos shtypesh e të mos ndjesh dhimbje! Ku ta dija se kur ishe gjallë, ti do të bëheshe shkak për të shtypur faljen e mëshirën në zemrën time dhe për shfaqjen e ndjenjave përvëluese… Më parë, ekzistenca e xhehenemit, nuk e qetësonte kaq shumë zemrën time…" Tha: "Si ka mundësi që vloi kazani? Shumë herë u tolerua, iu dha kohë dhe u përpoqën për të harruar të këqijat që ishin bërë, por për atë që e bëri këtë, çdo herë ishte e përshtatshme e njëjta e keqe."

Tani më thuaj, a nuk është padrejtësi të mos i japësh hakun atij që e meriton? Domethënë, a nuk është torturë për të që të mos ia kruash ndonjë vend të lëkurës, që është infektuar me sëmundjen e zgjebes? Çfarë duhet t'i bëjmë atij që e keqpërdor atë që mbulon gabimet e të tjerëve apo atij që nuk ia di vlerën falësit dhe ikën duke iu bërë barrë dhe mundim me gjëra që nuk i meriton?

Fatmirësisht ka gjuhë të ndryshme për të perceptuar të vërtetën dhe për t'u kuptuar ato që thuhen. Ja, vetëm se ka faj, këtu duhet të vijë në vete dhe nganjëherë duhet t'i ngjajë xhehenemit, në mënyrë që të mos vdesë dhe të hyjë në varr në këtë gjendje.

Xhehenemi është vendi i pastrimit... Vend i pastrimit për kë? Ai është vend pastrimi për besimtarët mëkatarë... Po qafirët e padrejtë? Ata faktikisht nuk do t'i pastrojë as xhehenemi. Xhehenemi për ata është vend ndëshkimi i përjetshëm. Kush mund të thotë se ai është një vend padrejtësie? Sigurisht se xhehenemi është vendi i larjes së hesapeve për ata që e meritojnë dhe që e kërkojnë me insistim.

Kam dëgjuar se xhehenemin do ta shikojnë pothuajse të gjithë. Të gjithë do të ndëshkohen pak për t'u pastruar nga mëkatet e mëdha apo të vogla që kanë bërë. Besimtarët do të hyjnë në xhenet më parë në raport me fuqinë dhe sinqeritetin e besimit të tyre.

Ashtu si hyrja e rrobës së papastër në lavatriçe për t'u larë. Sa më e madhe të jetë papastërtia, aq më e gjatë është koha e qëndrimit në lavatriçe, aq më shumë detergjent përdoret. Procesi i nxehjes së ujit, larja,

rrotullimi dhe tharja zgjasin më shumë. Përfundimi? Rroba të pastra për t'u vendosur në një ballkon për t'u tharë. Domethënë? Rroba të pastra. Po njollat e vështira që nuk dalin edhe pse janë larë shumë?

Aty nuk ka problem, sepse njolla e ngelur nga papastërtia nuk është papastërti. Po ngjyrat që zbehen nga larja e herëpashershme? Edhe rrobat që u janë zbehur ngjyrat apo janë vjetruar, nuk përbëjnë problem për faljen e namazit. Në këtë mënyrë, edhe zgjatja e kohës në xhehenem, nuk është pengesë për të hyrë në xhenet. Por siç dallohet rroba nga gjendja e saj, për shkak se është bërë me njolla dhe është larë, edhe njeriu i dalë nga xhehenemi do të dallohet nga gjendja e tij në xhenet. Të ecësh me njollën e papastërtisë, është më mirë se të ecësh më atë papastërti. Çfarë është më mirë? Më e mirë është ajo që nuk është përzier fare me papastërti dhe shkëlqen si dritë. Ja, kjo është më e mirë. Këtë nuk e di sa njerëz të mirë e kanë kësmet...

O peshk! Për shkak se nuk ke dalë asnjëherë nga uji, nuk e di se çfarë është zjarri. Shiko, tashmë je në kovë. A nuk bën sikur tani të isha pak zjarr dhe të të digjja, në mënyrë që të pastrohesh dhe të piqesh? Faktikisht, nëse nuk digjesh pak, atëherë bëhesh diçka e padobishme dhe e pangrënshme.

Unë nuk kam ndonjë qëllim të keq me ty. Zjarri im për papjekurinë tënde... Përndryshe, çfarë fitoj unë nga djegia jote? Asgjë! Atëherë, nuk ke zgjedhje tjetër përveçse të qëndrosh në zjarr dhe të përhapësh një erë si misk. Faktikisht, nëse të lë kështu, do të marrësh erë pa kaluar dy ditë. Në këtë mënyrë, bëhesh ushqim për macet e rrugës ose hidhesh në mbeturina dhe kalbesh.

I thash atij:

"Bashkë me çdo vështirësi, ka një lehtësim. Kështu që mos u mërzit!"

Pak paragjykim qenka i mirë nganjëherë...

Një njeri me fytyrë të ndritur, që e pushton zemrën me fjalë të ëmbla, mund të ketë qëllim të keq dhe mund të jetë zemërlig. Ata që i mendon të dobët, mund të dalin shumë të fuqishëm, të gëzuarit, mund të dalin me shumë halle dhe të mençurit mund të dalin shumë të paedukatë dhe egoistë. Atëherë, siç na ka porositur edhe i Dërguari i Allahut (a.s), që të mos bëjmë shumë paragjykime, ndonjëherë është mirë për të mbajtur në një qoshe pak paragjykim, thjesht për masa paraprake.

Shprehja "Largohuni nga paragjykimi i shumtë!" është shumë përfshirëse. Është aq përfshirëse, saqë, jo vetëm paragjykimin, por përfshin edhe mendimin e mirë. Siç mund të jetë naivitet dhe verbëri të menduarit gjithmonë për mirë, po ashtu, edhe paragjykimi i shumtë, në të njëjtën mënyrë, të shpie në një humbje besimi të pamatur. Atëherë, normaliteti edhe në mendim, qenka shumë i rëndësishëm.

Dikur, dikujt i kishte bërë keq vëllai i tij dhe kishte rënë në fatkeqësi. E pyeta:

"Përse nuk more masa kundrejt atij njeriu zemërlig që të bëri keq?"

Përgjigja e tij doli nga thellësia e shpirtit dhe në një mënyrë të pikëlluar:

"Sepse kurrë nuk prisja ndonjë dëm prej tij. Sepse nuk mendova se mund të jetë i sëmurë. Sepse gjithmonë mendova mirë për të. Sepse gjërat që ndodhnin, gjithmonë mendoja se vinin nga unë dhe nga dobësia ime. Sigurisht që ishte diçka e bukur që nuk favorizova veten dhe që i pashë gabimet e mia, por kundërshtarin tim nuk e paragjykova aq sa paragjykova veten time. Në këtë mënyrë, e teprova duke menduar mirë për të.

Edhe një gabim tjetër shumë i rëndësishëm ishte ky: "Asnjëherë nuk u frikësova, për shkak se nuk më shkonte ndërmend se do më bënte keq. Sipas meje, isha në një vend aq të mirë, saqë nuk kishte njerëz zemërligj dhe hajdutë. Prej atij që e ka emrin vëlla, njeriu nuk pret ndonjë të keqe. Unë i besova kësaj.

Kur më hyri frika? Kur fillova të thosha: "Vallë?" Unë e thashë shpesh për veten time këtë, por kurrë nuk dyshova te ai. Unë isha i sigurt nga kurthi i tij, ndërkohë që nuk isha i sigurt nga kurthi i vetes sime. Përse i dhashë kaq përparësi atij? Sepse ai ishte mysliman. Sepse e desha atë. Ai shpeshherë e vrau dashurinë, tolerancën dhe shpresën, por përsëri e fala shumë dhe prisja që të kthehej nga gabimi i tij.

Çfarë ndryshoi tani? Ai e përsëriti shpesh gabimin e njëjtë dhe tregoi se nuk është apo se nuk mund të jetë i sinqertë në pendimet e tij. Në këtë mënyrë, mendimi im kundrejt tij ndryshoi për shkak se e vrau atë që ndjeja për të. Masa paraprake më e mirë, ishte respektimi i dispozitave të sheriatit. Mirë, por çfarë do të bësh? Shikimi i tij ishte i dyshimtë... Sado që të qëndrosh drejt, ai përsëri të shikon me bisht të syrit. Çfarë do të thuash? La havle ve la kuvete!"

Për shkak se ngjarjet i pashë duke marrë mësim prej tyre, e kuptova se sa shumë e kam vështirësuar mëshirën e Allahut Teala dhe sa e kam bërë veten që të meritojë ndëshkimin, duke përsëritur gabimet e njëjta. E kuptova se edhe falja e ka një fund. Mëshira e tepruar të jep shumë vuajtje dhe lind shumë probleme. Kur çdo problem qan dhe të bën të qash si një fëmijë që lind me dhimbje, edhe mëshira fillon dhe pakësohet. Kot nuk kanë thënë:

"Ai që nuk merr vesh me këshillë, duhet të qortohet. Ai që nuk merr vesh nga qortimi, haku i tij është dajaku!"

Në këtë mënyrë, kush mund të thotë se është padrejtësi ta rrahësh shumë atë për të mirën e tij, kur e kërkon këtë si një i çmenduar?

Ata që shikojnë me kujdes, e kuptojnë. Ekzistenca e xhehenemit është shfaqje e drejtësisë nga ndershmëria dhe e mëshirës nga e kundërta e saj. Më parë, nuk interesohesha shumë. Tashmë kam shumë respekt për zebanitë (engjëjt e tmerrshëm) të xhehenemit dhe për shërbimin që bëjnë!

I thashë:

"Sigurisht, e vërteta do të dalë në pah dhe mashtruesi ka mashtruar vetëm veten e tij. La tahzen!"

Gjilpërat përvëluese, nganjëherë qenkan shërim...

Si umet i të Dërguarit të Allahut, (a.s), i cili thotë: "Myslimani mund të bjerë në çdo lloj gabimi, por kurrë nuk mund të gënjejë!..", mua nuk më pëlqen të mashtroj dhe nuk mund t'i duroj ata që mashtrojnë! Për këtë arsye, nuk më dhimbset ai i sëmurë që i jep informacion të mangët apo të dhëna të pasakta doktorit në lidhje me sëmundjen e tij. Sepse një njeri i tillë, është një fatkeq i dashuruar me sëmundjen e tij ose një mashtrues që nuk dëshiron të shërohet!

Një ditë, dikush tha:

"Më ka zënë një sëmundje shumë e rëndë. Nuk di çfarë të bëj."

Një i ditur që gjendej aty, iu përgjigj:

"Këshilla ime e parë është të mos e fshehësh sëmundjen. Po gjithashtu, mos shko t'ia tregosh hallin tënd çajxhiut apo pastruesit të spitalit. Njeriu që duhet t'ia tregosh sëmundjen, është mjeku. Ai është njeriu që do të të ndihmojë. Nëse ai dëshiron, interesohet vetë, përndryshe, urdhëron dikë tjetër që të merret me ty. Çfarë ndodh, nëse nuk e bën këtë? Sëmundja kthehet në një bishë të madhe duke u ushqyer me virtytin tënd.

Veçanërisht, nëse është një sëmundje ngjitëse, atëherë jo vetëm trupin tënd, por i shkatërron edhe të tjerët nëpërmjet teje, nëse i prek ata. Ja, atëherë, përgjegjësia jote bëhet edhe më e rëndë. Sahabët e nderuar nuk fshehën asnjë gjendje të tyre nga i Dërguari i Allahut, (a.s).

Faktikisht, Ai (a.s), ishte një doktor specialist. Në këtë mënyrë, e kuptonte sëmundjen dhe e ndjente dhimbjen e bashkëbiseduesve të tij, sapo i shikonte në fytyrë. Sa keq për atë njeri që nuk turpërohet prej Allahut Teala, por turpërohet prej njerëzve! Në të vërtetë, kjo është sëmundja më e rëndë dhe më e frikshme!.."

I thashë:

"Rezisto kundrejt padrejtësisë dhe përulu kundrejt së vërtetës! La tahzen!"

Nganjëherë zemërimi qenka hallall dhe e drejtë absolute...

Pyeti:

"Kujt i dhemb shpirti? Atij që rreh apo atij që rrihet?"

Më shumë i dhemb shpirti atij që "dashuron". Madje, kur njeriu detyrohet për t'i dhënë ilaçet e hidhura me dorën e tij dikujt që e do shumë, thotë: "Ah sa sprovë e madhe!" Njeriut i dhemb shpirti kur e shikon tjetrin të vuajë... Kur i bën gjilpërën, nga ana tjetër i ikën shpirti krejtësisht... Kur nxehet, e rreh, por nënës i dhemb shpirti më shumë se sa fëmijës. Shpeshherë njeriu është gjyryku i zjarrit të tij... Atëherë, në fushën e sprovës duhet të jemi të mençur e të kujdesshëm dhe duhet të bërtasim burrërisht në emër të kuajve të dhunuar:

"O kalorës i keq! Rrobat dhe kërbaçin i ke në rregull! Po ashtu, paske edhe mendjemadhësi! Sipas teje, ditke shumë, por ai mbi të cilin ke hipur, nuk është kalë. Ai është një mëz me shpirt të lirë! Me lejen e Allahut, ai do të jetojë jo brenda kufijve të të tjerëve, por vetëm atyre të Allahut Teala! Mos pandeh se gjithmonë do të jetë kështu. Ai do ta durojë barrën e tij. Bëje edhe një herë dhe do të shohësh se çdo të ndodhë!"

I thashë:

"Qëndro pranë të dhunuarve dhe të vetmuarve! La tahzen!"

Nganjëherë ai që të rri pranë, qenka dashuri e keqe...

Dhe tha:

"Ja, kuptoje se halli im është vullneti im. Edhe nëse zemërohem, përsëri është bashkëbiseduesi im. E di se i ka hije nderimi atij që ka vullnet... Kështu që ndihmoji vëllezërit e tu për të rregulluar gjendjen e tyre. S'ka dyshim se lidhja e dashurisë nuk bëhet me fjalë.

Edhe ndaj atij që i bën keq, do të të rrjedhë mëshirë nga zemra! Mos ki frikë!

Konsidero se pas vetëtimave do të zbresë begati. Dhe ki frikë! Nuk i dihet, ndoshta rrëketë do të shkatërrojnë çdo gjë!

Në sytë e tu ka një shi të përzier me borë, që nuk pushon asnjëherë... Në këmbë ke një baltë të fortë, që ta vështirëson ecjen... Lëre fluturimin, ndonjëherë qenka shumë e vështirë të hedhësh qoftë edhe një hap..."

I thashë:

"Nëse je i dashuruar, gëzohu edhe për fatkeqësinë! La tahzen!"

A bëjmë kujdes ndaj hakut të robit?

Seher Ajdën

Njeriu është një qenie sociale. Natyrshmëria e tij e bën të ndjejë nevojë për gjallesat përreth. Dashuria dhe të dashuruarit, të folurit dhe të mësuarit, marrja dhe dhënia pothuajse janë një domosdoshmëri e natyrshmërisë së tij. Edhe Ademi (a.s), i cili jetonte mes mirësive të xhenetit, ndjeu nevojë për bashkëshorte, shoqe, prandaj Allahu Teala krijoi nënën tonë, Havanë.

Ashtu siç është shumë i bukur të jetuarit së bashku në jetën sociale, ndihma dhe solidariteti, po ashtu edhe lidhja mes njerëzve dhe nevojat e jetës sociale janë ndër çështjet e rëndësishme që në të njëjtën shkallë kërkojnë përgjegjësi të madhe. Sa kohë që këto neglizhohen, përjetohen shqetësime në këtë botë dhe në ahiret.

Zoti i botëve, që është "Tevvab" dhe "Gaffur", "Kerim" dhe "Aluvv", ndërkohë që i pranon pendimet dhe i fal mëkatet, nuk i fal gabimet dhe padrejtësitë në sjelljet e njerëzve mes njëri-tjetrit (të drejta këto që përkufizohen si "haku i robit") dhe ia kalon atij të cilit i përket. Prandaj, në Kuranin Fisnik koncepti i padrejtësisë dhe shkeljes së të drejtave të të tjerëve përmendet 324 herë dhe shirku 174 herë.



Padrejtësi do të thotë: të heqësh një të drejtë nga vendi i saj, ta pengosh, të bësh padrejtësi.

Shirk do të thotë: t'i bësh padrejtësi Allahut, xhelle xhelaluhu dhe t'i shoqërosh shok Atij.

Është shumë interesant fakti që Zoti i botëve padrejtësinë, mosrespektin, fjalët dhe veprimet fyese që njeriu i bën njeriut, i ka theksuar më shumë se padrejtësinë, mosrespektin dhe fyerjet që i bëhen Atij. Kështu na ka urdhëruar të jemi më të kujdesshëm në këtë çështje. Prandaj të gjitha fetë që janë shpallur përgjatë historisë, kanë vendosur ligje të cilat mbronin shpirtrat e njerëzve, pasurinë, mendjen, brezat, fenë, nderin dhe moralin e tyre.

Zoti i botëve në Kuranin Famëlartë tërheq shumë vëmendjen ndaj këtyre dy koncepteve dhe thotë kështu për fundin e atyre që bien në këto gabime:

"Ata që nuk besojnë dhe bëjnë padrejtësi, Allahu nuk i fal, as nuk do t'i udhëzojë në kurrfarë rruge." (Nisa, 168)

"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë." (Nisa, 48)

Tregon Ebu Hurejre (r.a):

I Dërguari i Allahut, (a.s), i pyeti sahabët e nderuar:

"A e dini kush është i varfër?"

Sahabët e nderuar u përgjigjën:

"Për ne i varfër është ai që nuk ka para dhe pasuri."

I Dërguari i Allahut, (a.s) tha:

"Të varfrit e umetit tim janë këta njerëz të cilët do të vijnë në Ditën e Kiametit me namaz, agjërim dhe zekat, por në librin e tyre të veprave do të kenë të shkruara; shau këtë, shpifi me imoralitet për këtë,

hëngri mallin e këtij, mori të drejtën e këtij, përgjaku këtë, rrahu këtë. Në këtë gjendje sevapet e veprave të tij të mira i jepen këtij të fundit. Nëse sevapet i mbarohen para se të paguajë borxhet, i shkruhen mëkatet e atyre që u ka bërë padrejtësi. Pastaj hidhet në xhehenem. Ja, ky njeri është i varfri i vërtetë!" (Muslim, Birr, 59; Tirmidhi, Kijamet, 2.)

Në jetën sociale ku njerëzit jetojnë së bashku, kanë përgjegjësi dhe të drejtë respekti për njëri-tjetrin. Kjo e drejtë dhe përgjegjësi quhet "haku i robit". Haku i robit, ashtu siç mund të jetë një padrejtësi dhe lëndim i dukshëm, përmban edhe fjalë e sjellje që e dëmtojnë moralin e njeriut. Kështu çdo njeri ka hak të pakët sa një njeri tjetër të ketë të drejtën e të jetuarit, të qenit i lumtur, të dashuruarit, edukimit, njoftimit dhe udhëtimit. Parashikimet që bëhen për një person dhe përgojimi pas tij, ngaqë ka karakterin e sulmimit të reputacionit dhe moralit të tij, hyn në "hakun e robit".

Ebu Katade, (r.a.), tregon:

Një burrë e pyeti të Dërguarin e Allahut, (a.s):

"O i Dërguari i Allahut, a më falen të gjitha mëkatet nëse vdes në rrugë të Allahut?"

I Dërguari i Allahut, (a.s), i tha:

"Po, nëse ti bën durim, e pret shpërblimin (nga Allahu) dhe vdes në mënyrë burrërore, falesh!"

Pastaj Pejgamberi, (a.s), përsëriti:

"Po, përveç hakut të robit, të falen të gjitha mëkatet. Xhebraili më njoftoi tani për këtë!"

Njeriu, që është krijesa më e nderuar, duke u mposhtur shpeshherë nga nefsi që gjendet në strukturën e tij, mund të sillet në mënyrë mosmirënjohëse e egoiste dhe të bëjë mëkate të mëdha për interesa të ulëta. E drejta dhe përgjegjësia e dhunës, e cila përkufizohet si haku i robit, është shembulli më tipik i kësaj. Haku i robit, duke filluar nga bashkëshortët dhe fëmijët, të cilët jetojnë bashkë në jetën sociale, përmban edhe fqinjët, kolegët në punë, madje shoqërinë që formojmë në rrugë dhe të gjithë njerëzit me të cilët përshëndetemi.

Paraardhësit tanë janë treguar shumë të ndjeshëm në këtë çështje, duke u kujdesur dhe interesuar për çdo gjallesë, duke përfshirë këtu edhe kafshët. Ndërsa respekti që ata kishin për veprat dhe adhurimet e njerëzve me fe të ndryshme, të cilët i kishin në administrim, ka zënë vend në faqet e lavdishme të historisë.

Edhe ato që janë përjetuar në ndërtimin e Xhamisë Firuzaga në Sultanahmed, që është njëra prej xhamive të para që janë ndërtuar në qytet pas çlirimit të Stambollit, janë një prej shembujve të rëndësishëm të kësaj. Ngjarja vijon kështu:

Përgjatë ndërtimit të Xhamisë Firuzaga, romët pohuan se minareja e xhamisë ua zë diellin dhe i lë në hije qoftë edhe për një kohë të shkurtër 15-20 minuta jomyslimanët që banojnë afër xhamisë dhe aplikuan te administruesit e asaj kohe për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kërkesat e tyre u analizuan dhe u panë si të drejta.

Ndërkohë që deri atëherë te xhamitë me një minare, minarja vendosej në cepin e pasmë djathtas, në këtë xhami minarja u vendos në cepin e pasmë majtas. Kështu u tregua kujdes që sado pak qoftë, të mos dhunohej e drejta e robit.

Në çështjen e hakut të robit, që e ka të vështirë kompensimin, Pejgamberi, (a.s), këshillon:

"Betohem në Allahun se dynjaja kundrejt ahiretit është sa fryma e një lepuri. O robërit e Allahut! Bëni kujdes ndaj kufijve që ka vënë Allahu (xh.xh)! Bëni kujdes ndaj kufijve dhe kërkoni ndihmë nga Zoti ynë që është Allahu (xh.xh)." (Kenzu'l-Ummal, 43156.)

Kam nevojë...

Kubra Çoban

O vend i bekuar!

Nuk di asgjë për ty. Ato që kam në mendje për ty janë gjërat që kam dëgjuar nga njerëzit që kanë qenë atje, gjërat që kam lexuar nga librat dhe ato që kam ndjekur nganjëherë në televizor, në emisionet direkt nga Meka dhe Medina. Është një shpehje klasike, e cila thotë: "Nuk shpjegohet, por përjetohet." Unë mendoj se kjo fjalë më shumë duhet të thuhet për ty.

Them pandeh, sepse nuk jam e sigurt se mund të shpjegohet për shkak se nuk e kam përjetuar. Mund ta marr me mend vetëm nga gjërat që kam dëgjuar prej njerëzve që kanë qenë atje. Për të ditur, duhet të shohësh, të përjetosh dhe të përjetuarit ndryshon nga një njeri te tjetri. Jo çdo njeri e ndjen njëlloj çdo gjë. Çdo njeri do të marrë prej riskut të tij sipas aftësive që ka. E vetmja gjë që di është se të dua dhe kam nevojë për ty.

Kjo nevojë para së gjithash buron nga fakti se je një nga pesë kushtet e Islamit, sepse Allahu nuk ka nevojë për adhurimet tona! Jemi ne ata që kemi nevojë për adhurimet që kryejmë. Në të vërtetë për ata që nuk kanë mundësi, nuk ka detyrim, por në çfarëdo gjendjeje që të jem, unë kam nevojë të të shoh dhe të të ndjej!

Sa kohë që më shtohet nevoja dhe dashuria për të të parë, besoj se edhe ardhja tek ti do të më lehtësohet... Paraja? Shumë njerëzve, edhe pse jetojnë në vështirësi, Allahu ua mundëson të vijnë atje. Kjo punë, së pari ka të bëjë me dashurinë, zemrën, zjarrin e saj... Ai të cilit i digjet zemra, e gjen një rrugë.

Adhurimi i Haxhit është farz (obligim) për të pasurit dhe kësmet për të varfrit. Ndërsa kësmeti është i lidhur me zemrën e njeriut. Kam nevojë për një zemër dhe sinqeritet të tillë!

Edhe pse me shumë vështirësi, kam nevojë të ngrihem para agimit dhe të lutem:

"O Zoti im, na e bëj kësmet ne dhe të dashurve tanë të shkojmë në ato toka të shenjta! Na mundëso të perceptojmë dashurinë e atyre vendeve!"

Kur në zemër hyn dashuria, për të dashuruarin largësitë bëhen të afërta, të pamundurat bëhen të mundura. Në fjalorin e të dashuruarit nuk ka dorëheqje. Nëse vendos një herë të shkojë te i dashuri, nuk ka kthim pas për të. Heq dorë nga të ngrënët, të pirët, nga gjumi, nga nevojat dhe përgjërohet natë e ditë për të takuar të dashurin. Edhe i dashuri nuk ia çon dëm lutjet, por e merr menjëherë në audiencën e tij. Kam nevojë për një dashuri të tillë!

Kur the se nuk të mjafton jeta për të arritur në Qabe, nëse përparon me këtë shpejtësi, e vazhdove rrugën pa e humbur shpresën dhe the: "Unë kam nevojë për vendosmërinë e milingonës, e cila tha: 'Edhe nëse nuk arrij dot në Qabe, të paktën vdes në këtë rrugë!"

Kur zemrën e prek malli, e djeg dhe e përvëlon njeriun. Me atë djegie njeriu bën çdo gjë. Dashuria e të dashuruarit varet nga sakrifica që bën për të dashurin. Unë jam nevojtar i atij malli që ma mbush zemrën dhe më bën të sakrifikoj!

Kam nevojë të shkoj në tokat e shenjta, të shoh vendet ku ka jetuar i Dërguari i Allahut, (a.s), të ndjej aromën e Tij të këndshme, të njoh sakrificat që kaloi për ne, të ndjej dashurinë që Ai (a.s), kishte për umetin, të heq sado pak mallin dhe të qaj hallet me Të (a.s).

Në jetën tonë ka disa çaste të veçanta, si netët e mira, netët e premte që na i ka dhuruar Allahu dhe në të cilat lëshon mëshirën e Tij... Ka edhe vende në të cilat lëshon mëshirën si shi dhe në krye të këtyre vendeve vjen Qabeja madhështore.

Kam nevojë të shkoj atje dhe të marr pjesën time të mëshirës, t'i përgjërohem Allahut Teala për këtë botë dhe për botën e përtejme, të lutem shumë për vëllezërit e motrat myslimane, të dashurit e mi dhe për veten time!

Kam nevojë ta vizitoj shtëpinë e Allahut (xh.xh),

së pari se është urdhër i Tij, por edhe ngaqë në ajetin fisnik thotë:

"Kujtoje kur Ne vendosëm për Ibrahimin vendin e Faltores (duke e urdhëruar)*: 'Mos më shoqëro asgjë* (në adhurim) *dhe pastroje Shtëpinë Time* (nga idhujtaria), *për ata që vijnë rrotull saj* (në shenjë adhurimi) *dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde duke u falur. Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara mbi kafshët* (për kurban), *të cilat ua ka dhuruar Ai. Hani nga ato* (mishin) *dhe ushqeni nevojtarin e varfër!"* (Haxh, 26-28)

Kam nevojë të pastrohem, të bëhem krejt e pastër; ta pastroj trupin, shpirtin, mendjen dhe zemrën time!

Kam nevojë ta riparoj veten nga ana fizike dhe shpirtërore; të pastrohem nga mëkatet dhe të vij në gjendjen e pastërtisë së një bebeje të sapolindur, të filloj nga fillimi si një fletore boshe e papërdorur!

Në këtë vend të shenjtë, ku pranohen të gjitha pendimet, kam nevojë të lutem e të përgjërohem me pendimin më të madh, duke thënë: "Me gjithë gabimet e mia, dola me shpresë përpara Teje. Kam bërë shumë vepra të pahijshme, nuk munda të bëhem robi yt dhe erdha të më falësh. O Zoti im që posedon mëshirë të pafund, Ti e do faljen, prandaj m'i fal mëkatet!.."

Njeriu është i lumtur kur e adhuron Allahun, i dorëzohet plotësisht Atij dhe e do Atë (xh.xh). Kam nevojë të ndjej adhurimin e Ibrahimi (a.s), dashurinë, dorëzimin dhe sakrificën e tij; të mund të them "Lebbejk Allahume: Urdhëro o Zot" dhe këtë ta them jo vetëm me gjuhë, por edhe me zemër; të ndjej adhurimin tim ndaj Zotit deri në palcë dhe të jem çdo çast i lumtur me ndjesinë e të qenit rob i Allahut!

Zemra është e dobët dhe nuk mund të mbajë shumë ngarkesë. Fjala e pathënë e rëndon atë. Kam nevojë t'u them të afërmve dhe shoqërisë sime se sa shumë i dua, sa të rëndësishëm janë për mua; kam nevojë ta shpreh të gjithë dashurinë që ka përbrenda, t'u shpreh mallin të afërmve të mi që ndodhen larg!

Allahu Teala thotë: "Nuk e fal hakun e robit!"

Kam nevojë të bëj për vete zemrat që kam thyer; t'u kërkoj ndjesë njerëzve të cilëve u kam hyrë në hak; t'u ndodhem pranë njerëzve me zemër të thyer; të pajtohem me njerëzit me të cilët jam zemëruar; të harroj të këqijat që më janë bërë dhe të fal; kështu duke falur, të mund të meritoj faljen; të fitoj madje edhe dashurinë e armikut; të sundoj zemrat; të vizitoj të afërmit; të ndihmoj nevojtarët; shkurtimisht së pari t'i bëj tavaf Qabesë së zemrave!

Kam nevojë për çdo gjë që më çon te kënaqësia e Allahut; kam nevojë për të gjitha veprat dhe çdo mirësi, që të mund të fitoj dashurinë e Tij dhe ta meritoj të dal përpara Tij (xh.xh).

Për të shkuar te shtëpia e Allahut, kam nevojë për lutjet e të dashurve të mi, nënës, babait, të moshuarve, të brengosurve, të sëmurëve, nevojtarëve, fëmijëve dhe jetimëve!

O Zoti im, kam nevojë të të dua dhe t'i kryej në mënyrë të plotë urdhrat e Tua. Meqë dashuria e të dashuruarit varet nga sakrifica e tij, kam nevojë ta kryej ashtu siç e meriton këtë adhurim, i cili kërkon më shumë sakrificë nga ana materiale dhe shpirtërore!

"Allahu e ka bërë Shtëpinë e Shenjtë të Qabesë, muajin e shenjtë, kurbanin dhe shenjat e tyre vlera të përhershme për njerëzimin, në mënyrë që ju ta dini se Allahu di gjithçka që gjendet në qiej e në Tokë dhe se Ai është i Gjithëdijshëm për çdo gjë. (Maide, 97)

Siç thotë edhe Allahu Teala, kam nevojë për këtë shkak që të më drejtojë!

Kam nevojë në këtë rrugë për mbështetjen materialo-shpirtërore të shoqërisë, të të dashurve të mi dhe mbi të gjitha, kam nevojë për ndihmën tënde, o Zot!

Ka shumë nga ata që shkojnë në ato toka të shenjta dhe, edhe pse i kryejnë të gjitha obligimet, nuk u pranohet haxhi. Edhe unë kam nevojë të kërkoj haxh dhe umre të pranuar, të përgjërohem duke thënë: "O Zoti im, na mbro që të mos jemi prej tyre dhe na mundëso t'i kryejmë obligimet tona në mënyrë sa më të përsosur dhe që i përshtaten kënaqësisë Tënde!"

Kam nevojë ta vizitoj sa më shpejt Qabenë e madhëruar dhe të kërkoj nga Allahu Teala ndërmjetësimin e Pejgamberit, (a.s), pa më ardhur pleqëria dhe sëmundja, pa më mbërthyer shqetësimet e kësaj bote, në pranverën e jetës sime, ndërkohë që jam i fuqishëm; pa më mbaruar jeta dhe pa më trokitur Azraili!

Kam nevojë që, kur të më mundësohet ky adhurim, t'ia di vlerën dhe të mund të falënderoj; të mund të përfitoj sa të mundem nga atje, të jetoj gjatë gjithë jetës me begatinë e asaj drite dhe ta reflektoj atë te njerëzit përreth!

Kam nevojë të perceptoj nevojën time dhe të falënderoj me gjithë zemër Zotin tim, Poseduesin e mirësive të pafundme, që ma vuri thellë në zemër dëshirën ndaj këtij vendi të bekuar!

Njeriu nuk ngopet me bukuri, prandaj kam nevojë t'i përgjërohem të Plotfuqishmit të më mundësojë që të shkoj herë pas here në ato toka të shenjta!

Besimi kërkon dëshmi

Siç rrëfehet, i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka pyetur një ditë Harithin ؓ:

- Si u gdhive sot, o Harith?

Harithi:

- Si një besimtar i vërtetë, o i Dërguari i Allahut.

Pejgamberi ﷺ:

- Çdo gjendje dhe e vërtetë ka dëshminë e vet. Cila është dëshmia e vërtetësisë së besimit tënd?

Harithi:

- O i Dërguari i Allahut. Hoqa dorë nga bota dhe kënaqësitë materiale të saj, në atë mënyrë që ditët i kaloj në agjërim, kurse netët në namaz. Derisa arrita një gjendje të tillë, që arshin e Zotit tim ta shoh qartë.

Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut iu përgjigj:

"Tamam, o Harith! Ruaje zemrën kështu siç e ke! Ti e ke ndriçuar zemrën me dritën e Allahut. (Hejthemi, Mexhmau z-Zevaid, I, 57)

Në një version tjetër, Pejgamberi ﷺ, gjendjen dhe sinqeritetin e Harithit e konfirmon kështu:

"Kush dëshiron të shikojë një zemër të ndriçuar me dritën e Allahut, le të shikojë Harithin." (Ibn Haxher, Isabe, I, 289)

Ky rrëfim tregon se çdo pohim kërkon vërtetim dhe çdo vërtetim kërkon argument dhe dëshmitar. Pohimi më i madh i njeriut para Allahut është deklarimi se e beson Atë. Argumentet që shërbejnë për vërtetimin e këtij pohimi janë veprat dhe jeta sipas programit hyjnor.

Imani është përkufizuar si shqiptim me fjalë dhe miratim me zemër. Miratimin e saj, zemra e konfirmon, e shpreh përmes veprave të mira.

Imani është dashuri dhe treguesi i dashurisë është sakrifica. Sinqeriteti në besim është në raport të drejtë me sakrificën në rrugën e Allahut. Pra, veprat e mira janë pasqyrë që tregon nivelin e besimit.

Përsosja e imanit është e lidhur ngushtë me devocionin e thellë të jetës shpirtërore, kurse devocioni është arti i krijimit të miqësisë së ngushtë midis njeriut dhe Krijuesit, përmes mbrojtjes së zemrës nga ndalesat e Allahut, disiplinimit të dëshirave dhe zhvillimit të dhuntive shpirtërore. Devotshmërinë mund ta përkufizojmë edhe si përpjekje për të shpëtuar nga zemërimi dhe dënimi i Allahut, duke u strehuar në hijen e mëshirës së Tij.

Allahu në Kuran i porosit besimtarët:

"...Bëhuni të devotshëm, që Allahu t'ju japë dituri..." (Bekare, 282) Pra Allahu i dhuron dituri dhe urtësi njeriut sipas nivelit të marrëdhënies që ka me devocionin.

Besnikëria e njeriut në besim vihet në provë përmes vështirësive të ndryshme gjatë jetës së tij. ***"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë 'Ne besojmë', pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që Allahu të***

dalloje ata që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë." (Ankebut, 2-3)

Ashtu si pastërtia e arit përftohet përmes nxehtësisë së tij në temperatura tepër të larta edhe besnikëria në besim provohet përmes durimit, pranimit, tevekkulit dhe ruajtjes së qetësisë dhe ekuilibrit përballë fatkeqësive dhe vështirësive të ndryshme në jetë.

Nga kjo pikëpamje, besimtari i ngjason pozitës së floririt midis metaleve të tjera. Nëse bie në baltë, nuk humbet asgjë nga vlera e tij. Por si Asija, e cila, megjithëse ishte bashkëshortja e Faronit arriti përmes devotshmërisë, sinqeritetit dhe besnikërisë së saj të ruajë imanin. Ajo sakrifikoi veten për besimin.

Besimtarët e vërtetë e ruajnë qëndrueshmërinë shpirtërore dhe vetëdijen e adhurimit përballë çdo lloj forme të shfaqjes së sprovës, si në formën e shfaqjes në begati, si në fatkeqësi.

Pejgamberi ﷺ, gjendjen e besimtarit e ka shprehur përmes këtij krahasimi të bukur: *"Ai është si bleta, e cila ushqehet me ushqim të pastër, prodhon ushqim të pastër e të shëndetshëm dhe kur qëndron mbi lule, nuk e dëmton apo e prish atë."* (Ahmed ibn Hanbel, II, 199)

Besnikëria e besimit vihet në provë, herë përmes fatkeqësive, herë përmes mirëqenies. Reagimi i besimtarit përballë fatkeqësive dhe vështirësive është durimi dhe mbështetja e plotë tek Allahu, e shoqëruar kjo me përpjekje të njëpasnjëshme për të kapërcyer vështirësitë. Kjo lloj sjelljeje e çon njeriun drejt fitores së dashurisë së Allahut, e kundërta e kësaj, pra reagimi përmes revoltës dhe zemërimit e çon njeriun në shkatërrim dhe rrënim të plotë shpirtëror.

E njëjta gjë ndodh edhe me shfaqjen e sprovës në formën e mirëqenies dhe begatisë. Falënderimi ndaj Allahut për begatitë e dhëna dhe modestia përballë njerëzve, çon në fitimin e dashurisë së Allahut, në rast të kundërt, kur njeriu ia atribuon vetes të gjitha meritat e begative të zotëruara dhe pushtohet nga mendjemadhësia si Karuni, ai në fakt është në një shkatërrim dhe humbje të vërtetë shpirtërore. Të dyja këto lloj sprovash janë për të testuar dhe provuar sinqeritetin e besimtarit.

Reagimi i Pejgamberit ﷺ, përballë sprovave të tilla përbën shembullin më të përkryer dhe ideal për gjithë besimtarët. Mbas goditjes së fuqishme që i dhanë myslimanët idhujtarisë në luftën e Bedrit, Allahu zbriti një ajet, i cili pengonte përfshirjen e myslimanëve nga ndjenjat egoiste. ***"Sigurisht, nuk ishit ju që i vratë ata, por i vrau Allahu! Kur gjuaje, nuk ishe ti*** *(Muhamed)* ***që gjuaje, por ishte Allahu Ai që gjuante, me qëllim që t'u bënte besimtarëve një dhuratë të bukur. Vërtet, Allahu dëgjon dhe di çdo gjë."*** (Enfal, 17)

Në vazhdën e frymës së ajetit dhe modestisë, i Dërguari i Allahut ﷺ, megjithëse triumfator, hyri në Mekë gjithë modesti dhe thjeshtësi dhe nga goja e Tij e bekuar rridhnin vetëm fjalët: *"Jeta e vërtetë është jeta e përtejme".* Me këtë qëndrim, Ai ia kushtonte të gjithë suksesin e arritur Allahut, duke refuzuar në mënyrë kategorike çdo prirje egoiste që mund t'i hapte rrugë mburrjes dhe lavdisë personale.

❀

Sprovat, siç nxjerrin në pah besimin e vërtetë, nxjerrin në pah edhe virtytet dhe aftësitë e vërteta të njeriut.

Një ditë, kur Pejgamberi ﷺ, po merrte abdest, sahabët u afruan dhe filluan të fërkonin dhe lagnin sytë me ujin e abdestit të Tij ﷺ. Kur Pejgamberi i pyeti për shkakun e këtij veprimi, të gjithë njëzëri iu përgjigjën: "Për shkak të dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij."

Kundrejt mendimit të sahabëve, Muhamedi ﷺ, e shprehu kështu provën e dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij:

"Kush pretendon se do Allahun dhe Pejgamberin e Tij ose dëshiron të fitojë dashurinë e Allahut dhe Pejgamberit të Tij, atëherë, kur të flasë të thotë të vërtetën, të çojë në vend amanetin e dhënë dhe të sillet mirë me fqinjët." (Bejhaki, Shuab, II, 201; Tebrizi, Mishkat, III, 81)

Pejgamberi ﷺ, në hadithin e mësipërm deklaron qartë se dashuria nuk mund dhe nuk duhet të konsistojë vetëm në fjalë të thata. Dashuria shfaqet në ndjekjen e të dashuruarit. Është krejtësisht absurde të pretendosh se admiron dikë dhe nga ana tjetër të

sillesh në kundërshtim me atë që të kërkon ai. Një person i tillë, ose nuk është i sinqertë në dashuri, ose në veprimet që bën.

Një tjetër argument i besimit është edhe mëshira dhe virtyti i faljes. Këtu nuk bëhet fjalë për mëshirën që pak a shumë e ka çdo njeri, por për mëshirën që ka përkufizuar Pejgamberi ﷺ, në porosinë Profetike.

"Betohem tek Allahu në duart e të cilit është shpirti im, se nuk do të hyni në xhenet deri sa të mëshironi njëri-tjetrin."

Sahabët e nderuar i thanë:

"Ne të gjithë jemi të mëshirshëm, o i Dërguari i Allahut."

"Pejgamberi ﷺ, i sqaroi duke thënë: *"Mëshira që kam për qëllim nuk është vetëm mëshira midis jush, por mëshira në përgjithësi."*

Pra, zemra duhet shndërruar në një burim mëshire dhe dhembshurie, ku mund të shuajë etjen qetësisht çdo krijesë. Kjo mëshirë nënkupton mëshirën dhe dashurinë ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Kur njerëzit duhen midis njëri-tjetrit për hir të Krijuesit, atëherë zemrat e tyre bëhen të ndjeshme dhe delikate, në këtë mënyrë shtohet edhe më shumë dashuria dhe mëshira për njëri-tjetrin. Ata e dinë mirë se fitimi i mëshirës së atyre që janë në qiell është i lidhur ngushtë me mëshirën që tregohet ndaj atyre që janë mbi tokë.



Kur njeriu arrin këtë gjendje shpirtërore fillon të tolerojë gabimet që bëjnë të tjerët ndaj tij. Ai për hir të Allahut mëshiron dhe fal gabimet që bëhen kundrejt tij, duke mos i shndërruar ato në shkak për urrejtje dhe armiqësi.

Nga shembujt më unikë të kësaj gjendjeje është Ebu Bekri رضي الله عنه. Ebu Bekri ndihmonte një sërë njerëzish të varfër. Midis tyre ishte edhe një person me emrin Mistah, të cilit Ebu Bekri رضي الله عنه, ia preu ndihmën, për shkak se ishte njëri nga ata që kishin trilluar shpifje për Aishen رضي الله عنها, bashkëshorten e nderuar të Pejgamberit ﷺ dhe njëkohësisht vajzën e Ebu Bekrit رضي الله عنه. Për më tepër, u betua që nuk do ta ndihmonte më kurrë atë njeri. Si mundet një njeri të trillojë gjithfarë shpifjesh për vajzën e një personi, i cili i është gjendur pranë për çdo problem? Si mundet një njeri të shpifë kaq rëndë për bashkëshorten e nderuar të Pejgamberit ﷺ?

Por Allahu nuk e miratoi këtë vendim të Ebu Bekrit dhe urdhëroi që ndihma ndaj personit që shpifi ndaj Aishes رضي الله عنها, vajzës së tij të mos ndërpritej.

"Njerëzit e ndershëm dhe të pasur midis jush të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t'i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t'ju falë Allahu? Allahu është falës e mëshirëplotë." (Nur, 22)

Pas zbritjes së ajetit, Ebu Bekri tha: "Natyrisht që unë dëshiroj faljen e Allahut." Pas shlyerjes së betimit, Ebu Bekri e vazhdoi ndihmën për Mistahun. (Buhari, Megazi, 34; Muslim, Tevbe, 56)

Çfarë besimi, çfarë dashurie dhe çfarë nënshtrimi është ky, që bën të mundur të falësh një njeri, i cili ka trilluar shpifje për familjen tënde?

Vajza ndaj së cilës është trilluar është nëna e besimtarëve, bashkëshortja e Pejgamberit ﷺ, vajza e shokut më të ngushtë të Pejgamberit ﷺ dhe e familjes më të nderShme të ymetit.

Megjithë ato arsye të forta për t'ia ndërprerë ndihmën, sahabiu i nderuar e besnik Ebu Bekri رضي الله عنه, dëshmoi besnikërinë dhe sinqeritetin në besimin e tij duke iu nënshtruar plotësisht vullnetit të Allahut.

Prandaj, në momentin që deklarojmë: **"Amentu billahi / besoj Allahun"**, duhet të veprojmë dhe jetojmë sipas saj. Sprovave të ndryshme hyjnore, me të cilat mund të përballemi në jetë duhet t'u përgjigjemi sipas kritereve të imanit. Duhet të strehohemi gjithmonë tek mëshira, dhembshuria dhe ndihma e Allahut.

O Zot, mos na sprovo përtej fuqisë në këto ditë ku mbajtja e besimit në zemër është më e vështirë se mbajtja e thëngjillit. O Zot, na fal dhe na përfshij në mëshirën Tënde të pakufishme. Ti je shpëtimtari ynë. Sa mik dhe ndihmës i mirë je!

Amin...!

Shefika Kaja Meriç

Profeti im mësues

Klasa e parë, shkolla e parë dhe universiteti i parë... Dhe mësuesit sakrifikues që kanë dalë në rrugë për të predikuar këtë fe të shenjtë në të katër anët e botës. Pika e përbashkët e tyre është se të gjithë ata kanë kaluar nga bankat e edukimit të të Dërguarit të Allahut, (a.s). Mësuesi i të gjithëve, është i njëjti mësues dhe i njëjti njeri. Mësuesi i parë në krye të këtyre njerëzve të parë... Mësuesi i vetëm, Muhamed Mustafa, salallahu alejhi ve selem...

Në kohën e të Dërguarit të Allahut, (a.s), kur po përjetohej fillimi i çdo gjëje, nga ana tjetër po shkruhej receta e shpëtimit të njerëzisë. Po hidheshin bazat e një civilizimi të ri dhe një dorë hyjnore, me anë të atyre njerëzve të zgjedhur, po mundohej të thante batakun në të cilën njerëzia ishte zhytur deri në fyt.

I Dërguari i Allahut (a.s) dhe shokët e tij të zgjedhur, ishin "një shfaqje e mëshirës së Allahut Teala".

"Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara!" (Al 'Imran, 104)

Ja, shokët e të Dërguarit të Allahut (a.s), po përpiqeshin për t'u bërë një grup pikërisht si ai që shprehej në këtë ajet fisnik. Kryeheronjtë e kohës së të Dërguarit të Allahut, (a.s), po përpiqeshin për ta kryer në mënyrën më të mirë rolin që u ishte dhënë atyre, pothuajse, për të formuar pikën e kthimit të njerëzisë.

Ata i printe një njeri ideal dhe një personalitet shembullor. Një njeri që ishte pejgamber i pejgambereve. Një pejgamber që ishte i ruajtur nga Zoti (xh.xh), para dhe pasi erdhi në këtë botë!.. Nëse ai fliste, fliste prej Zotit, nëse heshtte, heshtte prej Zotit... Sepse "Ai nuk fliste nga dëshira e tij".

Allahu Teala e vendosi Atë në krye të njerëzve që do të formonin bërthamën e një qytetërimi dhe brenda kohës së revelatës, i dha çelësin e inteligjencës që do ta vazhdonte këtë edhe në shekujt e ardhshëm. Nisur nga kjo, për Atë nuk kishte asnjë lloj rëndësie raca, gjuha, pozita gjeografike dhe klasat e ndryshme njerëzore.

"Të gjithë ishin të barabartë si dhëmbët e krehrit përpara Allahut Teala".

"Epërsia ishte vetëm në devotshmëri".

Në këtë mënyrë, bota për Të ishte një universitet i madh, ndërsa njerëzit ishin studentët që po arsimoheshin në këtë universitet. Ai e edukonte umetin e tij me dhembshurinë e një mësuesi të mëshirshëm dhe të një babai të përsosur. Ashtu duhej ta edukonte. Ai duhej të ishte gjithëpërfshirës dhe i butë.

"Si duhet të jetë një mësues ideal?"

Përgjigja e drejtë që mund t'i jepet kësaj pyetjeje, mendoj se është kjo:

"Mësuesi duhet të jetë një njeri që ka pika të përbashkëta me studentët, të jetë i respektueshëm, i butë, të mos ketë vendime të prera, t'i falë ata, t'i dojë, të ketë durim ndaj reagimeve të tyre, të jetë personalitet shembullor, t'i dijë dhe t'i përdorë të gjitha metodat e përshtatshme të edukimit, të jetë sakrifikues, ndikues dhe të shfaqë sjellje që nuk bien ndesh me njëra-tjetrën."

Ja pra, i Dërguari i Allahut, (a.s), që i mbartte të gjitha këto veçori edhe shumë të tjera, i ndërtoi marrëdhëniet e Tij me umetin në një mënyrë që do të ishte shembull për të gjithë edukuesit.

Profeti i Zotit (a.s), në marrëdhëniet me sahabët dhe shokët e tjerë, i ka vendosur me fjalë, me sjellje dhe me praktikë ligjet që do të bëheshin rregulla të arta të arsimit edhe pas qindra vitesh.

Kur i shikojmë parimet e vendosura shkencërisht në librat e edukimit të sotëm dhe të cilat pranohen si të domosdoshme për t'i praktikuar në mënyrë kategorike, që të merret një frytdhënie qind për qind nga edukimi, vëmë re se në jetën e të Dërguarit të Allahut, (a.s), ato parime janë praktikuar në formën më të bukur.

Ne mund t'i radhisim kështu këto parime që i Dërguari i Allahut, (a.s), i ka praktikuar në marrëdhënie me njerëzit dhe të cilat janë shembull i shkëlqyer për të gjithë mësuesit:

- Kur sahabët ishin në një gjendje të pashpresë, të dobët dhe poshtëruese, Ai i bëri që t'i besojnë fesë së Tij dhe vazhdimisht u jepte shpresë dhe i përgëzonte ata.
- I shpërblente dhe i vlerësonte sjelljet pozitive.
- Ngjallte interesim duke bërë pyetje.
- Nuk nxitonte, në mënyrë që bashkëbiseduesit e

tij ta kuptonin çështjen.

- Ai i ndau në kohë ato që do t'u thoshte dhe respektoi ligjin përshkallëzues të edukimit.

- Atyre ua shpjegonte çështjet duke dhënë shembuj. Në këtë mënyrë, përfitoi nga tregimet dhe historitë për t'i mësuar ata.

- Ai sugjeronte që fëmijët të shkojnë në xhami, në këtë mënyrë, i shpinte ata në kuvendet e dijes.

- Ndaj të gjithëve sillej me butësi dhe tolerancë.

- Fjalët i përsëriste, në mënyrë që të gdhendeshin në mendje ato që thoshte.

- Fliste në atë mënyrë që e kuptonin njerëzit.

- Ai nuk kundërshtonte njeriun, por sjelljen e gabuar.

- Atyre që ishin të dhënë pas dijes, u sugjeronte të mësonin gjuhë të huaj.

- Njerëzve u fliste duke vizatuar, duke bërë përngjasime dhe me gjuhën e trupit.

- Ai i praktikonte ato që thoshte dhe ua mësoi të tjerëve duke i përjetuar edhe vetë.

Me këto veçori, i Dërguari i Allahut, (a.s), ishte mësuesi më i mirë i umetit. Ai (a.s), ishte dërguar për t'i mësuar umetit urdhrat dhe ndalesat që kishte marrë nga Allahu Teala.

Një mësues i tillë!..

Një mësues i cili dha edukim në kushtet më të vështira në një popull ku injoranca përjetohej më ndjeshëm se kudo... Një mësues që nuk tregoi as edhe animin më të vogël ndaj asgjëje të kësaj bote, që shfaqi një qëndrim dinjitoz dhe që tha: "Nuk dua asgjë përveç kënaqësisë së Zotit.".

Një mësues i cili interesohej për umetin e fëmijët e tyre dhe që shqetësohej për hallet që ata kishin.

Një mësues i cili ia kushtoi çdo çast të jetës edukimit, inteligjent dhe gjykues i ngjarjeve të cilat habisnin edhe rrethet më intelektuale të kohës, por që në njërën anë mund të gjente një gjuhë të përbashkët edhe me shtresën më të ulët të shoqërisë për sa i përkiste dijes.

Një mësues i cili sillej me të gjithë sipas nivelit që kishin dhe që e përdorte në mënyrën më të bukur gjuhën e trupit...

Allahu që në fillim të profetësisë së tij ia dha atë detyrë me urdhrin:

"O ti i mbuluar! Çohu dhe paralajmëro!" dhe në rreshtat e parë të shpalljes vendosi urdhrin hyjnor: ***"Lexo! Me emrin e Zotit që krijoi** (gjithçka)**!"*** Të lexuarit ishte edhe kushti i parë, madje më i pari i detyrës së tij si mësues për nxënësit e Tij (a.s). Ai, duke e zgjeruar domosdoshmërinë e kësaj, kuptimin hyjnor që qëndronte në këtë urdhër ia vuri detyrë vetes që të mësonte, t'i mësonte të tjerët, të kuptonte, të jetonte dhe t'i bënte edhe të tjerët të jetonin.

I vetëm, pa njeri...Vetmi të cilën e ndjeu kur filloi detyrën si pejgamber në mes të atij populli, i cili e admironte virtytin dhe karakterin e tij të lartë!.. Një mësues i cili u braktis nga më të afërmit e tij. Madje ata e shanë, e përbuzën, e rrahën, e shtynë, e lanë të vetëm e për më tepër, e dëbuan nga vendi i Tij...

Por Ai qe një mësues i cili, pavarësisht gjithë kësaj shtypjeje, qëllimin e parë që i vuri vetes në jetë ishte të ndante me popullin shijen e besimit, mëshirën e Allahut Teala, pa u lodhur e pa u mërzitur... I detyruar të emigronte, edukimin e shoqërisë shembullore të cilën përpiqej ta ndërtonte në Mekë, e vazhdoi në Medine. Shëtiti derë më derë e qytet më qytet... Shkoi në Taif... Ndaloi karvanet që kalonin në rrugë me shpresën se do të gjente dikë që ta dëgjonte... Pa u lodhur, pa u mërzitur... u qante hallet njerëzve me përgjegjësinë shpirtërore të të qenit mësues...

Sa kuptimplotë është ky hadith fisnik nga ana e vlerës që Ai (a.s), i jepte umetit:

"Gjendja ime me tuajën ngjan me këtë: Një burrë ndez një zjarr. Kur vendi përreth ndriçohet, fluturat e natës dhe shumë kafshë që e pëlqejnë zjarrin, fillojnë të afrohen tek ai. Burri mundohet t'i pengojë, por kafshët e sfidojnë dhe shumica e tyre bien në zjarr. Unë ju kap ju nga beli e nga rripi, që ju të mos bini në zjarr, por ju vraponi për të rënë në zjarr!" (Buhari, Rikak, 26)

Një pejgamber, i cili e mban fort umetin e Tij që të mos binte në zjarr... Një pejgamber i cili e vuri jetën e tij në qendër të mëshirës që tregonte për ta...

O i Dërguari i Allahut! Ne umeti Yt, po dëgjojmë në banka si nxënës që sapo kanë filluar shkollën. Dëgjojmë sihariqet e Tua, të cilët sfidojnë horizontin dhe emocionohemi me to.

Po, ashtu, siç ke thënë edhe Ti, ne jemi si fluturat që rrotullohen rreth zjarrit. Nuk dimë se ç'bëjmë. Zjarrin e pandehim kopsht trëndafilash, ndërsa xhamat e thyer, ujë. Na mblidh ne nxënësve të Tu poshtë fletëve të Tua të mëshirës. Na pyet, na bëj t'i përsërisim ato që na tregon!

Na trego për Ibrahimin. Na trego për vëllezërit e Tu pejgamberë, Musanë, Jusufin, popullin Ad, popullin Semud.

Na trego për besimin, mirësinë... Të të dëgjojmë Ty gjithë kujdes, pa na u dridhur qerpiku, pa lëvizur kokën...

Esselamu vesselatu alejke ja Rasulullah!... Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ty, o i Dërguari i Allahut!

Elif Menxhel

ÇDO NJERI MUND TË NDIHMOJË

Çdo njeri duhet të ketë ndonjë të varfër, nxënës apo të sëmurë të cilin të mund ta ndihmojë.

Nuk duhet të ulemi çdo ditë në kolltukun tonë të ngrohtë dhe të mjaftohemi me panoramën që mund të shohim. T'i sjellim në mendje dhe të mendojmë për ata të cilët ndodhen jashtë në dëborë, në shi, në furtuna të ftohta, në varfëri dhe që konsumohen pa rrugëzgjidhje. Nuk mjafton vetëm t'i shohim, por duhet t'i ndihmojmë ata sa të kemi mundësi.

Çdo njeri ka mundësi të bëjë diçka. Kur thuhet ndihmë, çuditërisht njerëzve gjithmonë u vjen në mendje paraja ose ndihma financiare. Sigurisht që ka vende ku edhe ajo është e domosdoshme. Ata që nuk kanë mundësi materiale, të paktën t'i ndihmojnë fizikisht dhe shpirtërisht. Një fjalë thotë: "Jepuni të dashurve tuaj një trëndafil, nëse nuk keni trëndafil, buzëqeshuni atyre!.."

Ka njerëz që e kanë të mirë gjendjen materiale, por nuk mund të bëjnë Pazar, ngaqë janë të moshuar. Ka edhe nga ata që e kanë të vështirë të respektojnë mysafirin ose që kanë nevojë për miqtë, për të folur e biseduar me ta. Ata do të gëzoheshin shumë, nëse i vizitojmë ndonjëherë dhe i pyesim për shëndetin. Ata nuk duhet të ndihen të hedhur mënjanë, ngaqë janë plakur. Duhet t'i bëjmë për vete… Të marrim mësim nga ngjarjet që kanë jetuar dhe të përfitojmë nga përvoja e tyre.

Sa bukur e shpreh Mevlana:

"Atë që të rinjtë nuk mund ta shohin në pasqyrë, të moshuarit e shohin në një copë tulle."

Ne mund t'i marrim në shtëpi dhe t'i ndihmojmë fëmijët të cilët presin te dera nënat e tyre të kthehen nga puna, apo fëmijët e sëmurë të fqinjit, të cilët janë të detyruar të qëndrojnë në shtrat të vetëm në shtëpi.

Ka gra të cilat, edhe pse kanë para, nuk mund t'i kryejnë nevojat më themeltare të familjes, si pazarin, drutë, qymyrin, doktorin etj., ngaqë nuk kanë burrë dhe djalë. Ka baballarë të cilët ditën punojnë në ndërtim, natën në punë të tjera dhe e kanë të vështirë të paguajnë qiranë e shtëpisë. Megjithatë mundohen të përkujdesen për fëmijët e tyre.

Këtyre njerëzve mund t'u japim nga rrobat tona të pastra dhe të rregullta, edhe pse mund t'i kemi veshur më parë, gjëra të përdorura dhe ushqime që na ndodhen tepër në një qoshe.

Disa njerëz e pandehin botën të përbërë vetëm nga ajo që shohin nga dritarja e shtëpisë së tyre. Ngaqë nuk dalin nga ai ambient, gjejnë një rrugë për të mbrojtur veten, duke thënë:

"Ku ka të varfër? Lypsarët marrin shumë para."

Nuk janë të gjithë aq të pandershëm apo pa rrugëzgjidhje sa të lypin… Përreth nesh ka plot njerëz që nuk e bëjnë të dukshme gjendjen e tyre, që mundohen të jetojnë me ato që gjejnë nëpër plehra, që mbledhin letra e gjëra të tjera natën duke mos dashur t'i shohë njeri, që mbërthejnë ushqimet e hedhura pas një dite pazari…

Dëgjoj nga fëmijët se ka nga ata nxënës që janë në vitin e fundit të fakultetit të mjekësisë, të cilët në atë të nxehtë të verës punojnë në ndërtim për të kryer pa-

gesën e shkollës, madje disa edhe plagosen, ngaqë nuk janë mësuar. Ndërkohë që disa rendin pas markave, për t'i përngjarë dikujt me modelin e flokëve, duke ndjekur modën, disa të tjerë janë nevojtarë për një supë të ngrohtë dhe një copë bukë të thatë…

Nëse, kur dilni nga shtëpia, dilni me nijetin se sot do të ndihmoni dikë, Allahu Teala patjetër që do t'ju përballë me dikë që të mund ta ndihmoni.

Kur fëmijët e mi ishin të vegjël, përparëset ishin të zeza. Dy përparëse: kur laja njërën, i vishja tjetrën. Një ditë nxënësit kaluan përpara derës sime në parakalim për provat e festës. Më tërhoqi vëmendjen një vajzë në fund. Përparësja e saj e zezë, e zbehur nga dielli, ishte vjetruar shumë dhe pothuajse ishte bërë ngjyrë kafe. Kushedi sa nxënës e kishin veshur!..

Fëmija, kopsat e pasme të përparëses së të cilit i ishin këputur, bënte dy-tre hapa dhe mundohej të mblidhte jakën, e cila i hapej në të dy anët. U mërzita shumë… Mora menjëherë përparësen e dytë, shkova në shkollë dhe ia tregova mësueses gjendjen. Mendoj se ishte nxënëse e klasës së parë. Kur e thirri nënën e saj në shkollë dhe ia dha përparësen, ajo tha:

"Do ta fsheh këtë, që ta veshë për festa dhe vitin që vjen!.."

Domethënë se diçka që për ne është e vjetër dhe e pavlerë, për të tjerët ndonjëherë mund të jetë shumë e domosdoshme.

Një miku ynë bëri kurban. Kur po hipnim në makinë bashkë me bashkëshortin për të shkuar ta shpërndanim atë, pamë një fëmijë rreth të dymbëdhjetave i veshur pastër, i cili mundohej të përkulej në një bidon të madh plehrash, por trupi nuk i mjaftonte për këtë. Ishte e qartë se po kërkonte diçka.

I thashë:

"Bir, eja të të jap mish dhe t'ia çosh nënës!"

Fëmija nuk e priste një fjalë të tillë. Ia dhamë mishin, ndërkohë bashkëshorti i dha edhe para fëmijës. Fëmija, kur pa paratë në grusht, fluturoi nga gëzimi…

"Xhaxha. Nga e kuptove që kisha nevojë për këto para?.. Ka katër ditë që mundohem t'i bëj këto para, sepse njëra nga katër rrotat e karrocës më është thyer. Po mundohesha të gjeja ndonjë gjë në plehra dhe ta rregulloja. Me këtë karrocë mbledh letra dhe gjëra të tjera, nxjerr harxhimet e shkollës dhe kujdesem për nënën!.." Pastaj mori karrocën dhe vrapoi i gëzuar.

Edhe pse ne i thamë: "Kujdes trafikun bir", ai u largua i gëzuar pa na dëgjuar.

Disa njerëz, të cilët shohin mallrat në një panair që organizohet nga institucione bamirëse apo në tezgjahët e atyre që vendosin dy-tre gjëra për të fituar me djersë bukën e gojës, nuk e fusin dorën në xhep dhe thonë:

"Kjo nuk më hyn në punë. Nuk kam fëmijë të vegjël!.." ose:

"Kush do ta lexojë këtë libër, revistë apo kalendar?"

Por…

Kemi aq shumë fëmijë, njerëz të cilët kanë nevojë për to...

Ata trima bëjnë pazar në dyqane të shtrenjta.

Babai im i ndjerë e bënte shpesh këtë. Kur unë dhe motra ishim të vogla, erdhi në shtëpi me një thes me spinaq. Në një vend të nxehtë si Adana ato kohë nuk kishte as frigorifer…Në shtëpi ishim vetëm dy fëmijë të vegjël, kush do ta hante gjithë atë spinaq… Të paktën të ishte njeri i pasur!.. Nëna i tha:

"Ç'është kjo gjendje zotëri?"

Babai i tha:

"Një shoku im sapo kishte hapur një dyqan dhe që nga mëngjesi nuk kishte shitur asgjë. E si do të çonte ushqim në shtëpi?! Nëse i jepja para, ndoshta mund të prekej. Prandaj unë ia bleva të gjithë spinaqin. Nëse ngel deri nesër, prishet. Bëji çfarë të duash, po deshe shpërndajua fqinjëve!.."

Qofshim të shëndetshëm apo të sëmurë, të gji-

thëve na ka rënë rruga nga spitali. A i keni vënë re të sëmurët atje ose të afërmit, të cilët presin jashtë pa rrugëzgjidhje? Ata të cilët nuk kanë ku të rrinë dhe flenë në bahçen e spitalit ose nëpër makina… A keni menduar ndopak për ata njerëz të cilët kalojnë ditë vetëm me simite, mes dhimbjes dhe shpresës përpëliten pa rrugëzgjidhje dhe heqin vuajtje të panumërta larg vendit dhe shtëpisë së tyre?!

Sidomos në ditë të mira e hapin iftarin duke ngrënë përtokë… Shumë njerëz, të cilët nuk mund të bëjnë banjë dhe nuk kanë rroba të tjera përveç atyre që kanë veshur… Sidomos nënat… Vetëm të shihni rrobat e fëmijëve të tyre të sëmurë!.. Në operacionin e bashkëshortit, veçanërisht çonim në spital rroba fëmijësh dhe infermieret më thoshin:

"Ka nga ato nëna që kanë ardhur për lindje dhe nuk kanë rroba për beben, t'ua japim atyre!.."

Në çdo cep të spitalit duhet të ketë një mencë për ata njerëz të cilët presin jashtë… Sikur ata të cilët i kanë afër shtëpitë të interesoheshin pak për këtë, sepse mund të vijë dita që edhe ne mund të biem në të njëjtën gjendje. Sa mirë do të ishte sikur ta ndanim sa të mundnim atë që kemi në duar…

Në veprën e tij me titull "Fryma e Fundit", Hoxha i Nderuar Osman Nuri Topbash thotë:

"Në varre i pasuri dhe i varfri do të qëndrojnë pranë e pranë… Asnjëri nuk do të ketë mundësi për t'i dhënë tjetrit, as tjetri nuk do të ketë nevojë për diçka të tillë!"



Sa kemi kohë, ta vlerësojmë çdo gjë të cilën posedojmë. Pasuria, shëndeti, mundësitë materiale, të gjitha janë amanete të cilat na janë dhënë në mënyrë të përkohshme… Inshallah amanetet ia paraqesim në mënyrën më të bukur poseduesit të vërtetë…

Janë katër persona të cilët do të nxitojnë për të hyrë në xhenet:

I pari është "agnija shakirin", pra i pasuri i cili e ka harxhuar pasurinë e tij në rrugë të Allahut.

I dyti është dijetari që ka vepruar me dijen e tij.

I treti është ai që ka rënë dëshmor në rrugë të Allahut.

I katërti është ai person, haxhi i të cilit është pranuar...

Engjëjt e pyesin të pasurin:

"Ku e harxhove gjithë këtë pasuri?"

Ai tha:

"Amanetet që më dha Allahu, vetëm që të fitoj kënaqësinë e Tij, i harxhova përsëri në rrugë të Tij."

Engjëjt i thanë:

"Prit radhën!"

Pyesin dijetarin:

"Si e posedove ti këtë dije?"

Dijetari tha:

"Unë isha fëmijë i një familjeje shumë të varfër. Një i pasur më ndihmoi, kisha edhe kapacitet. Mësova, studiova dhe u bëra dijetar."

"Edhe ti prit radhën."- thanë engjëjt.

Pyetën dëshmorin:

"Si u bëre dëshmor?"

Ai tha:

"E dhashë jetën në rrugë të Allahut pa m'u dridhur qerpiku."

"Po mirë, ku e mësove se rënia dëshmor është kaq me vlerë?"

"Nga dijetari."- tha dëshmori.

Ata i thanë si të tjerëve më parë: "Prit edhe ti radhën tënde!"

Radha i erdhi haxhiut të nderuar, të cilin e pyetën:

"Si dhe nga kush e mësove vlerën e të qenit haxhi?"

"Nga dijetari."- u përgjigj haxhiu.

"Edhe ti prit radhën!"- i thanë atij.

Pas kësaj, të parin në xhenet futën të pasurin, i cili ndihmoi dijetarin të edukohej dhe të bëhej shkak për shumë mirësi te njerëzit. Të dytin futën dijetarin, pastaj dëshmorin dhe haxhiun…

Kur e pyetën një mik të Allahut "Çdo të thotë të japësh?", ai u përgjigj:

"Të japësh do të thotë të lumturohesh me gëzimin e tjetrit!.."

Nëse ne si individë dhe shoqëri kërkojmë lumturi, kemi nevojë për një mobilizim më të madh shpirtëror.

Ndihmesa e të sëmurit, jetimit, të vetmuarit, nevojtarit dhe njerëzve të uritur është një borxh falënderimi ndaj Allahut (xh.sh). T'i ndajmë me nevojtarët të gjitha mundësitë që kemi, në mënyrë që këta njerëz të cilët i kemi gëzuar dhe u kemi fituar zemrën, të bëhen gjendja jonë shpirtërore në këtë botë, ndihma në ahiret dhe lumturia jonë në xhenet!..

ROSTO Pule

PËRBËRËSIT:

- 500 gr mish i grirë pule
- 1 gotë uji bizele të ziera
- një karotë • 1 spec i kuq
- 1 qepë • 1 vezë • 1 lugë gjalpë
- 1 tufë e vogël majdanoz
- 1 gotë çaji buke e grirë,
- kripë • piper i zi • rigon • qimjon

PËRGATITJA:

Vendoset mishi i grirë i pulës në një enë dhe grihet qepa. Vezës i shtohen erëzat, vaji, majdanozi dhe buka e thekur e grirë dhe përzihen. Speci i kuq dhe karota ndahen në formë kubash të vegjël. Pastaj shtohen edhe bizelet dhe përzihen të gjitha. Masën e vëmë në një vend të sheshtë dhe e bëjmë në formë ruloje, pastaj i hedhim bukën e grirë. Pas kësaj e mbështjellim me letër alumini dhe e pjekim në temperaturën 200 gradë. Që pjesa e sipërme të skuqet, gjatë pjekjes e hapim pak letrën në pjesën e sipërme. Nëse dëshirojmë, roston mund ta shoqërojmë me një salcë të përgatitur me 3 domate, 3 thelpinj hudhre, borzilok, vaj ulliri, kripë dhe piper të zi.

Sultjash ME FTONJ DHE KARAFILA

PËRBËRËSIT:

- 1 litër qumësht • 1 gotë sheqer pluhur
- 4 lugë oriz • 2 lugë niseshte • 1 e verdhë veze
- lëkurë limoni e grirë • tre ftonj
- 3 fara karafili • 3 lugë sheqer pluhur

PËRGATITJA:

Vendoset orizi të ziejë, në mënyrë që uji të cilin i kemi hedhur për zierje të kalojë 3 cm mbi oriz. Në një tenxhere tjetër vendoset për t'u zier qumështi me sheqer. Pastaj qërohen ftonjtë dhe ndahen në kuba. Kubave të ftonjve u hidhen sipër 3 lugë sheqer dhe karafilat, pastaj piqen në një tavë derisa të mos kenë lëng. Në një tas përzihen e verdha e vezës me niseshte dhe pak ujë. Qumështit në fillim i hidhet orizi, pastaj niseshteja dhe kështu lihen të ziejnë. Pasi ziejnë për një kohë të shkurtër, i shtohet edhe lëkura e limonit. Ftonjtë ndahen nëpër gjyveçë (tas prej qeramike). Nëpër gjyveçë hedhim edhe sultjashin e përgatitur, pastaj ata i vendosim në një tepsi të mbushur me ujë dhe i pjekim në furrë në temperaturën 250 gradë derisa të fillojë të skuqet pjesa e sipërme e sultjashit.

Ju bëftë mirë!

Halixhe Kubra



O Allah!

Ndihmoje njeriun që nuk ka frikë nga varfëria

"Me të vërtetë , Zoti yt i jep me bollëk e ia kufizon (riskun) kujt të dëshirojë; Ai i di dhe i sheh mirë robërit e Vet." (Isra, 30)

Një ditë më pyeti vajza:

- Nënë, a jemi të varfër ne?

Nuk dija se çfarë përgjigjeje t'i jepja asaj, prandaj mendova pak...

- Jo,- i thashë.

- A jemi të pasur?

- Jo, ne jemi një shtresë e mesme.

Në fakt kjo përgjigje nuk më bindi as mua...

Nuk mund të them se jemi të varfër, sepse faleminderit Zotit, kemi mjaft të ardhura sa për të kaluar muajin. Nëse na mbaron mielli kemi oriz, nëse mbaron ai, kemi makarona. Nëse na mbarojnë prodhimet e qumështit, kemi produktet që na kanë sjell nga fshati: djathë, salcë, ullinj e shumë gjëra të tjera. Ndërsa po i numëroja të gjithë këto, i thashë vetes: "Jemi të pasur, shyqyr Zotit."

Në atë moment mendova për çastet më të vështira të varfërisë që kishin jetuar Pejgamberi (a.s), me shokët e tij në luftën e Hendekut. Ishte dimër dhe të gjithë kishin lidhur gurë në bark nga dhimbja që u jepte uria. Pranë Pejgamberit (a.s), shkon një nga shokët e tij. I tregon me dorë gurin që ka të lidhur në bark për t'i lënë të kuptojë se është i uritur. Ndërkohë në barkun e Pejgamberit të nderuar ishin 2 gurë, do të thotë se ai ishte më i uritur se shoku i vet.

Pejgamberi (a.s), hapi duart dhe filloi të lutej:

"O Allah, nëse Ti nuk do të na kishe udhëzuar, ne nuk do të falnim namaz dhe as nuk do të jepnim lëmoshë!"

* * *

Nga ky hadith kuptojmë se pasuria më e madhe është udhëzimi në fenë e drejtë, falja e namazit dhe dhënia e lëmoshës. Me të vërtetë që jeta e njerëzve që nuk janë të bekuar me besimin në Allah dhe vdekja e tyre e trishtueshme nuk më del nga mendja... Për të mos folur për namazin, i cili është dhurata më e bukur që na është dhënë... Jo çdokush ka fatin ta përjetojë atë ndjesi që të fal namazi. Si do të ishte fundi ynë, sikur Zoti të mos na kishte zgjedhur për të qenë besnikë të Tij?! Tashmë, çdo njeri që mendon se është i varfër, por që gëzon pasurinë me emrin besim, nuk duhet ta ndjejë veten të varfër.

Faleminderit Zotit, unë jam e pasur! Sigurisht që varfëria është një provë shumë e vështirë në këtë rrugë të dashurisë... Është i rëndësishëm durimi që duhet të kemi në këto raste dhe aftësia për të kthyer këtë gjendje të vështirë në diçka prej së cilës mund të përfitojmë të mira në botën tjetër... Pejgamberi (a.s) dhe shokët e tij janë një shembull i përsosur i kthimit të varfërisë në bekim.

Xhabir (r.a), tregon:

Në ditët e luftës së Hendekut po gërmonim një llogore. Përpara na doli një shkëmb shumë i madh. Sahabët shkuan pranë të Dërguarit dhe i thanë:

- Ka dalë një shkëmb në rrugën e llogores që po gërmonim.

Pejgamberi (a.s) tha:

- *Unë do të zbres në llogore.*

Ai kishte në bark një gur, sepse kishte tri ditë që nuk kishim asgjë për të ngrënë.

Pejgamberi (a.s), mori në dorë kazmën, e goditi shkëmbin e fortë dhe ai u thërrmua. Unë i thashë:

- O i Dërguar, më lejo të shkoj në shtëpi.

Kur mbërrita në shtëpi, i thashë gruas sime:

-Kam shikuar Pejgamberin në një gjendje, në të cilën është e pamundur të durohet, a ka ndonjë ushqim në shtëpi?

- Ka pak elb dhe një kec,- m'u përgjigj ajo.

E preva kecin dhe e blova elbin. Mishin e vendosëm në tenxhere dhe futëm pak bukë që kishim në furrë. Ndërsa ushqimi po ziente, unë shkova tek i Dërguari i Allahut dhe i thashë:

- O Resulallah! Kam pak ushqim në shtëpi, merr dy ose tre shokë me vete dhe na urdhëroni.

- *Sa ushqim ka?*- më pyeti.

Unë i tregova se sa dhe çfarë ushqimi kishte. Ai më tha:

- *Ushqimi qenka i shumtë dhe i mirë. Thuaji gruas tënde që të mos e heqë tenxheren nga zjarri derisa të vij unë dhe as bukën të mos e nxjerrë nga furra!*

Pastaj u kthye nga shokët e vet dhe u tha:

-*O njerëzit e Hendekut! Xhabiri na paska përgatitur neve gosti, hajde urdhëroni!*

Unë vrapova i shqetësuar tek gruaja ime dhe i thashë:

- O çfarë po na ndodh!.. Pejgamberi po vjen bashkë me të gjithë muhaxhirët, ensarët dhe gjithë të tjerët.

Gruaja më tha:

- A të pyeti ty i Dërguari se sa ushqim kishim?

- Po.

- Atëherë mos u shqetëso kot, sepse Ai e di më mirë se ti,- më qetësoi ajo.

Një moment më vonë, kur mbërritën të gjithë, i Dërguari u tha:

- *Futuni brenda pa shtrënguar njëri- tjetrin!*

Ata u futën brenda në grupe prej dhjetë personash. Pejgamberi ynë e merrte bukën dhe e ndante, mbi të vendoste mish dhe ua jepte shokëve. Sa herë që bënte këtë veprim, e mbyllte tenxheren dhe furrën. Ai e përsëriti disa herë këtë veprim. Njerëzit që erdhën ishin mbi një mijë, Pejgamberi (a.s), vazhdoi të ndante bukë e të vendoste mish mbi të derisa të gjithë njerëzit u ngopën. Në fund teproi edhe pak ushqim. I Dërguari i Allahut iu drejtua gruas sime duke i thënë:

- *Hani ju nga kjo dhe jepju edhe fqinjëve, sepse uria i shkatërroi njerëzit!..*" (Buhari, Meazi, 29; Myslim, Eshribe, 141; Vakidi, II, 452.)

Kjo është një mrekulli që i ka ndodhur Pejgamberit tonë. Ai, me lejen e Allahut ushqeu një mijë njerëz dhe ushqimi teproi edhe për fqinjët.

Pejgamberi (a.s), e shpenzoi të gjithë pasurinë e Tij në rrugën e Allahut, prandaj nuk kishte shumë gjëra nën pronësi. Kur kishte ndonjë nevojë nuk ia tregonte askujt, madje mundohej ta fshihte, sepse nuk donte të rëndonte askënd. Gjithsesi shokët e Tij ishin shumë të kujdesshëm dhe sapo shikonin që Pejgamberi kishte një nevojë, mundoheshin ta ndihmonin.

Kur vinin re që zëri i Pejgamberit ishte i dobët si pasojë e urisë, ata vraponin për tek shtëpia e tyre për të marrë çfarëdo ushqimi që mund të gjenin. (Shiko: Buhari, Etime, 6 ; Myslim, Eshribe, 142.)

Kur shikonin se fytyra e Pejgamberit ishte e zbehtë si pasojë e pangrënies, ata vraponin për t'i gjetur ushqim. Kur nuk gjenin asgjë, punonin për të larë devetë, me qëllim që të fitonin disa hurma për t'ia sjellë më pas Pejgamberit të dashur.

Një ditë Pejgamberi ishte pranë një shoku. U takua me një ensar, i cili i tha:

- O Pejgamber! Nëna dhe babai im të qofshin kurban, më mërziti shumë kjo çehre e fytyrës Tënde, cili është shkaku i kësaj?

Pejgamberi (a.s), e shikoi pak fytyrën e atij njeriu dhe i tha:

-*Uria.*

Sahabi vrapoi menjëherë për tek shtëpia e vet dhe kërkoi diçka për të ngrënë, por nuk gjeti asgjë. Menjëherë shkoi në Beni Kurajza dhe bëri marrëveshje që të merrte nga një hurmë në këmbim të çdo kove uji që do të nxirrte nga pusi. Kur mblodhi një grusht me hurma shkoi pranë Pejgamberit të dashur dhe e gjeti në vendin ku e kishte lënë.

- O i Dërguar i Allahut, urdhëro dhe ha këto!

Pejgamberi i botëve e pyeti se nga vinin këto hurma dhe ensari ia shpjegoi. Pejgamberi (a.s), i tha:

- *Më duket se ti e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij!*

Ai njeri i ktheu këtë përgjigje:

- Po, i betohem Atij që të ka dërguar Ty se për mua Ti je më i dashur se vetja ime, fëmijtë e mi, familja ime dhe pasuria ime.

Pejgamberi (a.s), i tha:

– Meqë qenka kështu, bëj durim ndaj varfërisë dhe qëndro i fortë para problemeve! Betohem në Allah se këto të dyja (varfëria dhe problemet) për njeriun që më do mua kalojnë më shpejt se rënia e ujit nga mali. (Hejsemi, X, 313; Zehebi, Sijer, III, 54; Ibn-i Haxher, el Isabe, III, 298)

Sikur të donte Pejgamberi (a.s), për të do të zbrisnin nga qielli sofra të mbushura me ushqime nga më të mirat. Sikur Ai të donte, malet do të ishin bërë ar për Të... Por Ai zgjodhi varfërinë. Sikur varfëria të ishte diçka prej së cilës duhet të ndjenin turp para Allahut (xh.sh), atëherë Ai do të kishte vendosur të ishte i pasur. Ai, me varfërinë e Tij u bë një shembull shumë i mirë për të gjithë pasuesit.

Ka pasur një periudhë kur Pejgamberi ynë ka qenë shumë i pasur. Edhe në atë rast Ai ka zgjedhur të jetonte si njeri i thjeshtë dhe pasuria i është bërë shkak vetëm për lartësimin e shpirtit të Tij. Po japim një shembull:

Një nga të parët e politeistëve kurejshë, Safvan Bin Ymejje, edhe pse nuk ishte mysliman, nuk i ishte ndarë të Dërguarit të Allahut për asnjë çast.

Gjatë kohës që Pejgamberi ynë i dashur po shëtiste për të shikuar mallrat e fituara në atë luftë, vuri re që Safvan bin Ymeje po shikonte me lakmi drejt një lugine të mbushur me deve .

Pejgamberi (a.s), që po e shikonte këtë skenë me bishtin e syrit, i tha:

– Ebu Vehb! Sikur po të pëlqen ajo luginë?

Safvan bin Ymeje iu përgjigj:

- Po!

Profeti (a.s), tha:

– Ajo luginë me çdo gjë që ka brenda është e jotja!

Safvani u emocionua shumë dhe tha:

- O i Dërguar, zemra e askujt nuk është kaq bujare sa e Jotja!.. Unë dëshmoj se përveç Allahut nuk ka Zot tjetër dhe dëshmoj që Muhamedi (a.s), është rob dhe i dërguar i Tij!..

Në këtë mënyrë ai u bë mysliman.

Pas kësaj, ai u kthye nga fisi i vet i kurejshëve dhe u tha:

- O fisi im, bëhuni edhe ju myslimanë, sepse Muhamedi bën dhurata të tilla që të largojnë nga varfëria!

Nuk ka rëndësi nëse je i pasur apo i varfër!.. Qëllimi ynë parësor në këtë jetë është fitimi i dashurisë së Allahut pa marrë parasysh rrethanat në të cilat ndodhemi. Sikur Allahu të kishte dashur, të gjithë njerëzit në këtë botë mund të ishin të pasur, por atëherë pengesat që na matin besimin nuk do të kishin kuptim. Duhet të ekzistojnë edhe njerëzit e varfër, në mënyrë që i pasuri t'i ndihmojë ata dhe të fitojë Dashurinë Hyjnore... Kurse i varfri mund ta fitojnë atë Dashuri duke u treguar i durueshëm ndaj fatit të tij. Kjo temë është shpjeguar kështu në Kuran:

"Disa prej jush Allahu i ka pajisur më mirë. Por, ata të cilëve u ka dhënë më shumë, nuk u japin furnizim atyre që i kanë nën vete, edhe pse janë të barabartë në nevoja. Si po i mohoni dhuntitë e Allahut?" (Nahl, 71)

"Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiqet për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet."

"Ne i mbështesim të gjithë me dhuratat e Zotit tënd: edhe këta, edhe ata. Dhurata e Zotit tënd nuk i mohohet askujt."

"Shiko, si Ne i parapëlqejmë disa ndaj të tjerëve. Kurse bota tjetër, në të vërtetë, do të ketë shkallëzime më të mëdha dhe parapëlqime më të theksuara." (Isra, 19-21)

"Vërtet mendoni të hyni në Xhenet, pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjerimi dhe sëmundjet dhe, aq shumë u tronditën, saqë çdo i dërguar dhe ndjekësit e tij, thirrën: 'Kur do të arrijë ndihma e Allahut?!' Ja, ndihma e Allahut është afër!" (Bekare, 214)

Allahu bëftë që të jemi prej njerëzve të Tij të dashur edhe kur jemi duke vuajtur nga varfëria, edhe kur jemi të mbrojtur nga pasuria! Qofshim ne ndjekës të denjë të Profetit tonë, që nuk u frikësua asnjëherë nga varfëria! Amin...

Flutura Ura

A kam aftësi sipërmarrëse?

E ardhmja e një kombi varet nga dëshira e njerëzve për t'u arratisur nga format konçize të të menduarit e për të sjellë ide të reja. Dëshirë kjo e bazuar mbi parimin ku investimi i sotëm është lumturia e së ardhmes.

Kush jam unë? Një pyetje në dukje e thjeshtë, por jo edhe aq në përmbajtje. Njohja e vetvetes është çelësi që hap portat drejt një jete të suksesshme. Thuhet që njeriu është produkt i mjedisit, por unë mendoj që njeriu e krijon vetë mjedisin e tij. Unë jam ajo që zgjedh të jem. Ndoshta edhe padashur njerëzit përfshihen në vorbullën e ideve dhe realizimi i tyre përfaqëson gradën më të lartë të suksesit njerëzor. Një univers i tërë krijimtarie fshihet brenda çdo njeriu, qoftë edhe në skutat më të thella të mendjes, ai ekziston. Edhe unë e kam një të tillë. Hapi i parë për ta zbuluar është këndvështrimi optimist i të parit të gjërave. Shtoji një dozë vullnet, ca pika durim e mbi të gjitha, shumë pasion. Mjafton të dëshirosh!

Te rikthehemi tek unë. A zotëroj unë aftësi sipërmarrëse? Do të doja te isha modeste, por natyra njerëzore më ka falur edhe anën e gjykimit të drejtë të gjërave. Përderisa ekzistoj, kam të gjitha mundësitë dhe të drejtat e botës për t'i zotëruar këto aftësi. Arti i fjalës është një formë e shfaqjes së tyre. Të jem sipërmarrëse do të thotë të mbaj barrë të mëdha mbi supe, por askush nuk mund të më tregojë që s'mund t'i mbaj këto përgjegjësi. Dhe e dini pse ndodh kjo? Sepse brenda meje ekziston dëshira për të bërë gjërat e zakonshme në mënyrë të jashtëzakonshme. Besoj që në rrugën e sipërmarrjes udhërrëfyesi më i drejtë është mendimi dhe bashkudhëtari më i mirë është veprimi. Ashtu siç jam e sigurt që koha është gjykatësi më i paanshëm i vlerave të gjithsecilit.

Jo gjithmonë arrijmë të nxjerrim në pah aftësitë tona, prandaj esenca e natyrës njerëzore na orienton drejt dilemës së pazgjidhshme: t'i përshtatemi botës apo ta bëjmë botën t'i përshtatet natyrës sonë? Ndihem optimiste, pasi kam shanse për të lënë gjurmët e mia të skalitura në forma të pavdekshme. Mund t'i lë këto gjurmë, sepse para së gjithash jam femër: një qënie me shpirt konkurues e që nuk dorëzohet lehtë, nismëtare e aftë për t'u përballur me sfida, e drejtë në gjykim e me parime morale dhe ambasadorja më e mirë për të respektuar të drejtat e njeriut. Kjo jam unë!

Mos ki frikë të ndërmarrësh iniciativa të reja. Përderisa je gjallë, ndjehu i tillë. Luaj me instrumentët e jetës dhe krijo simfoninë e përkryer të ekzistencës tënde.

Fatma Allada

PASURIA
NUK ËSHTË GJITHMONË BEKIM

Ekzistojnë vende aq të bukura, që na mahnisin të gjithëve... Kur i shikoj këto vende të mrekullueshme, gjithmonë në mendje më vjen kjo pyetje:

"Vallë, me çfarë provash gjykohen aty brenda?"

Kjo botë nuk është vendi i rahatisë!.. Secili nga ne është në një provim me pengesa të ndryshme. Pasuria është një porosi që na e ka dhënë Allahu. Unë mendoj se për çdo gjë do të japim llogari. Çdo gjë qe zotërojmë duhet ta shpenzojmë në rrugën e Allahut. Nuk duhet të harrojmë se paratë dhe sendet nuk janë asgjë tjetër vetëm një mjet për të fituar kënaqësinë e Allahut. Duhet të kemi kujdes për të plotësuar nevojat e njerëzve të varfër, sepse Allahu i ka lënë njerëzit e varfër në përgjegjësinë e të pasurve.

"Në pasuritë e tyre ka pjesë për lypësit dhe nevojtarët." (Dharijat, 19)

Nuk duhet ta llastojmë egon tonë me pasuri e prona, sepse të gjitha ato mund t'i humbasim një ditë.

Allahu (xh.sh), në ajetin në suren Tegabun thotë:

"Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju. Allahu ka shpërblim të madh." (Tegabun, 15)

Nga ky ajet kuptojmë se pasuria është si një thikë me dy presa... Ka njerëz të pasur, që harrojnë se është Krijuesi që i ka dhënë këtë pasuri dhe mendojnë se vetëm ata janë zotërues të saj.

"Këtë e kam fituar unë me punën time dhe me talentin tim... Askush nuk ka të drejtë në pjesën time!.."

A nuk mendon se kush të ka dhënë forcën, mendjen, zgjuarsinë dhe aftësinë për të fituar para dhe mallra të ndryshme? Këta njerëz lavdërohen me makinat, shtëpinë dhe pasurinë, ata bëhen pre e krenarisë së tyre.

Askush nuk mund të jetë më i lartë se njerëzit e tjerë... Kjo gjë mund të arrihet vetëm me përkushtimin ndaj Allahut (xh.sh). Disa njerëz janë aq të zënë me fitimin e mallit të kësaj bote, saqë e harrojnë Zotin. Qëllimi i një besimtari duhet të jetë fitimi i kënaqësisë së Zotit; për këtë duhet të përpiqemi që fitimi ynë të jetë vetëm në rrugë të drejtë; duhet të bëjmë kujdes dhe të qëndrojmë larg haramit dhe gjërave të ndaluara. Më mirë të kemi pak, por të jenë gjëra të fituara në rrugë të hallallit, sesa të kemi shumë, por të jenë gjëra të fituar në rrugë të ndaluara nga feja jonë.

Kur të mbyllësh sytë për herë të fundit, cilën nga mallrat që ke fituar në këtë botë do të marrësh me vete? Do të marrësh vetëm veprat e tua... Do të marrësh duatë që të kanë bërë njerëzit për veprat e mira që ke bërë... Do të marrësh sevapet që ke fituar kur ke gëzuar njerëzit në nevojë...

Si mund të marrësh pronën e dikujt tjetër?! Nëse në mallin që ti ke fituar kanë të drejtë njerëzit e varfër ose njerëzit në nevojë, si mund të ndjesh krenari me gjërat që zotëron?.. Allahu (xh.sh), i paralajmëron kështu njerëzit që bëjnë padrejtësi dhe ata që janë koprracë:

"O besimtarë! Në të vërtetë shumë priftërinj dhe murgj përlajnë pasurinë e njerëzve pa të drejtë dhe i largojnë ata nga rruga e Allahut. Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut,

paralajmëroji me dënim të dhembshëm.

Do të vijë dita, kur** (thesaret e mbledhura) **do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t'u thuhet : 'Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!" (Teube, 34-35)

Këta janë njerëz që i kanë humbur betejat e kësaj bote, janë të pasur, por nuk kanë fituar dashurinë e Allahut. Të jesh i pasur nuk është gjë e mirë gjithmonë, nganjëherë pasuria mund të bëhet shkak për humbjen e xhenetit.

Disa të pasur janë për t'u pasur zili. Ata janë modestë dhe nuk bëjnë asnjë veprim pa menduar për llogarinë që do të japin para Allahut (xh.xh). Ata harxhojnë për vete vetëm aq sa u nevojitet. Nuk janë të dhënë pas luksit dhe pas shpenzimeve të tepërta. Ata janë gjithmonë falënderues dhe mjaftohen me aq sa zotërojnë. Këta njerëz fillojnë nga të afërmit duke pyetur se kush ka nevojë për ndihmë dhe e vazhdojnë këtë gjë me njerëzit e tjerë. Ndihmat që u japin njerëzve të tjerë i shikojnë si një përfitim. Nuk harrojnë se kush është zotëruesi i vërtetë i pasurisë që kanë. Ata janë gati të flijojnë çdo gjë që kanë për hir të Allahut. Kur ata dhurojnë diçka, Allahu thotë:

"Robi im, ti jep për hir të dashurisë Sime, unë do të jap ty edhe më shumë pasuri!"

Këta të pasur modestë nuk e harrojnë se sa të vegjël janë para Zotit dhe nuk mburren me pasurinë e tyre. Ata i lejojnë paratë që të futen vetëm në xhepin e tyre, jo në zemra. Garojnë me njëri – tjetrin në shpenzimin e pasurisë për hir të Krijuesit, prandaj janë të pasurit që Allahu i do. Në këtë mënyrë, pasuria është një dhuratë për ta.

* * *

Nga ana tjetër, varfëria jonë nuk është një ndëshkim, nganjëherë ajo është një bekim i vërtetë. Kur Zoti na i pakëson fitimet, nuk duhet të mendojmë se Ai nuk na do më. Sikur kjo logjikë të ishte e saktë, atëherë Pejgamberi për të cilin është krijuar e gjithë bota nuk do të jetonte asnjëherë në varfëri. Allahu (xh.sh), thotë në Kuran:

"Vallë, a mos janë ata që e ndajnë mëshirën e Zotit tënd? Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët, më qëllim që disa t'u shërbejnë të tjerëve. Mëshira e Zotit tënd është më e mirë nga ajo që grumbullojnë ata." (Zuhruf, 32)

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"O biri i Ademit! Ty të vjen fati(risku) çdo ditë, por përsëri je i trishtuar. Çdo ditë na pakësohet jeta, por ti përsëri je i lumtur. Ke të mira aq sa ke nevojë, por ti kërkon atë që do të përkeqësojë gjendjen tënde. Nuk të del pak as nuk mjaftohesh me shumë."

Ne shohim disa të varfër që nuk kanë asgjë tjetër veçse një veshje për të mbuluar trupin, një vend për të futur kokën dhe një copë bukë të thatë dhe janë të lumtur me këto dhe falënderues ndaj Allahut. Ata janë të kënaqur nga dhuratat e Zotit dhe Ai është i kënaqur prej tyre... Njerëzit që dinë të mjaftohen me ato që kanë në dorë, janë njerëz të lartë. Nuk bëhen kryengritës për shkak të gjërave që u mungojnë, por përkundrazi, janë durimtarë. Kur kanë një nevojë i luten Allahut (xh.sh), vetëm Atij i kërkojnë ndihmë. Këta njerëz janë të zgjedhur nga Allahu, Ai i do ata. Duatë e tyre nuk mbesin të paplotësuara. Për hatër të tyre edhe shoqëria në të cilën jetojnë begatohet nga Allahu i Lartë. Zemrat e tyre janë të ndjeshme, por ata që nuk janë në dijeni të kësaj nuk sillen mirë me to.

Disa të varfër të tjerë ankohen vazhdimisht për gjendjen e tyre. I flasin për gjendjen e tyre të mjerueshme çdo njeriu që u del përpara. Si mendon, kujt po i ankohesh dhe për çfarë? Ai që na jep çdo gjë është vetëm Allahu... Kur gjejnë diçka për të ngrënë, në vend që të falënderojnë, kërkojnë më shumë. Janë mosmirënjohës. Gjithmonë i kanë sytë tek pasuria e njerëzve të tjerë. I kanë zili njerëzit e pasur. Mërziten shumë kur shikojnë pasuritë e tyre. Shqetësimet dhe nevojat e tyre rriten dita- ditës. Këta janë njerëz me qëllime të këqija. Allahu i ruajtë të gjithë njerëzit (të pasur e të varfër) nga kurthet e tyre.

Nëse kërkon pasuri, duhet ta kërkosh atë për ta harxhuar në rrugën e Allahut, në rrugë të fitimit të drejtë... Krijuesi ynë e di këtë çështje më mirë se ne.

Ai thotë kështu, në ajetin 71 të sures Nahl:

"Disa prej jush Allahu i ka pajisur më mirë. Por, ata të cilëve u ka dhënë më shumë, nuk u japin furnizim atyre që i kanë nën vete, edhe pse janë të barabartë në nevoja. Si po i mohoni dhuntitë e Allahut?"

Si përfundim, mund të themi që i varfri ka nevojë për të pasurin, ashtu siç i pasuri ka nevojë për të varfrin! Askush nuk duhet të krenohet me pasuritë që zotëron, ashtu siç askush nuk duhet të ankohet për gjërat që i mungojnë.

Besimtari është ai njeri që në çdo gjendje ku ndodhet, arrin të përfitojë për t'iu afruar Allahut. Ai i lutet Allahut kur i zvogëlohet pasuria dhe askujt tjetër.

O Allah, na jep neve pasuri, që të na ndihmojë afrimin me Ty. Na dhuro para të cilat t'i harxhojmë vetëm në rrugën Tënde! Mos lejo që të kemi nevojë për askënd tjetër përveç Teje... Ti je Ndihmues! Amin.

Dr. Betyl Inall

USHQYERJA ARTIFICIALE

Ushqyerja me qumësht, formulë e fëmijëve të cilët nuk kanë mundur të marrin qumësht gjiri në 6 muajt e parë, është quajtur "ushqyerje artificiale". Qumështi formulë është qumësht që merret nga lopa, por që është ndryshuar në mënyrë industriale duke i ngjarë qumështit të nënës. Këtyre u thuhet edhe ushqimi i bebes. Energjitë e këtij ushqimi janë të përafërta me qumështin e nënës.

Ushqyerja e bebes me qumësht formulë duhet të zgjasë të paktën 6 muaj dhe, nëse është e mundur, deri në moshën 1 vjeç. Nëse për ushqyerje zgjidhet qumështi i lopës, në 6 muajt e parë përdoret masa 2/1 (2 masë qumësht, 1 masë ujë), nëse zgjidhet qumështi i deles, duhet të përdoret duke e përzier qumështin gjysmë për gjysmë me ujë (1 masë qumësht, 1 masë ujë)

Ushqimet paraqiten në treg duke u emërtuar si fillestar, vazhdues dhe ushqimi me lugë. Ushqimet fillestare jepen 4-6 muaj, ushqimet vazhduese pas muajit 4-6 dhe janë produkte që i ngjajnë përbërjes së qumështit të nënës. Ndërsa ushqimet me lugë janë produkte që i lehtësojnë bebes kalimin te ushqimet shtesë.

Çështja që duhet të bëni kujdes kur përdorni ushqimet fillestare dhe vazhduese është zgjedhja e atyre produkteve që nuk e ngarkojnë shumë veshkën. Këtë mund ta mësoni duke pyetur doktorin.

Në ushqyerjen artificiale është e rëndësishme që ushqimi të përgatitet me përpikëri. Fëmijëve që nuk kanë marrë kurrë qumësht gjiri, mund t'u jepet edhe me biberon. Para se të përdoren, pajisjet duhet të pastrohen duke u zier. Pas përdorimit, duhet të pastrohen përsëri me ujë të ngrohtë dhe duhet të tregojmë kujdes në përdorimin e biberonit.

Ushqimi duhet të përgatitet sipas masës që sqarohet mbi kuti. Shtimi i masës së ushqimit mund të bëhet shkak që bebes t'i ngarkohen më shumë lëndë minerale dhe të marrë kg të panevojshme.

Uji që duhet të përdoret në përgatitjen e ushqimit, duhet të jetë ujë i vluar dhe i vakët. Nuk duhet të harrojmë se në ujin që zihet herë pas here rritet sasia e lëndëve minerale (sodium) dhe bëhet shkak për shtimin e ngarkesës së veshkave të bebes.

Nuk duhet të përdoret ushqimi që ka tepruar nga hera e mëparshme, por çdo herë duhet të përgatitet ushqim i freskët. Para çdo ushqyerjeje duhet të jemi të sigurt për pastërtinë e biberonit.

Ngaqë ushqyerja e bebes me biberon në mënyrë të shtrirë mund të bëhet shkak që ushqimi t'i kalojë në rrugët e frymëmarrjes, bebja duhet të ushqehet duke e mbajtur atë të ulur në prehër, gjysmë drejt dhe kokën të mbështetur në krahun e nënës. Ndërsa mbajtja e shishes drejt dhe mbushja plot e majës së biberonit ndihmon beben të parandalojë gëlltitjen e ajrit. Kohëzgjatja e një vakti nuk duhet t'i kalojë 30 minuta. Nuk duhet të mundohemi t'i japim bebes me zor më shumë ushqim se ç'dëshiron. Pas ushqyerjes, ashtu siç veprohet edhe pas gjidhënies, duhet t'i nxjerrim bebes gazin e gëlltitur.

Te fëmijët që ushqehen njëkohësisht edhe me qu-

mësht gjiri edhe me ushqim, duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe ngulmues për të mos e lënë gjidhënien. Së pari bebja duhet të ushqehet me gji, pastaj, pasi të jemi siguruar se gjinjtë janë boshatisur dhe bebja akoma nuk është ngopur, duhet t'i jepet ushqimi shtesë.

Sa të jetë e mundur nuk duhet të përdoret biberoni, por ndërkohë duhet të kihet kujdes që bebes t'i jenë dhënë kaloritë e mjaftueshme. Sipas kërkimeve që janë bërë, është parë se bebet prematurë (e parakohshme) madje, mund të pinë në filxhan. Por nuk do të jetë e lehtë që bebet në katër muajt e parë ta shtyjnë ushqimin me gjuhë.

Fëmijëve që nuk mund të marrin as qumësht gjiri, as qumësht formulë, mund t'u jepet qumësht lope duke e holluar 2/1 me ujë, 150 ml për çdo kilogram. Për shembull një bebeje që peshon 3 kg, duhet t'i jepet 450 ml. në ditë nga përzierja e përgatitur. Nga kjo 300 ml. duhet të jetë qumësht, 150 ml. ujë. (Mund t'i hidhet 1 lugë çaji sheqer) Duhet bërë kujdes që qumështi i lopës që do t'i jepet bebes, të jetë i zier mirë.

Te bebet që nuk marrin qumësht gjiri, ushqimet shtesë mund t'u fillohen para muajit të 6. Por nuk është e përshtatshme t'u fillohet para 3 muajsh. Nëse bebja juaj ka arritur dyfishin e kilogramëve të lindjes, konsumon më shumë se një litër qumësht formulë në ditë, kërkon të ushqehet më shpesh se në një interval kohor prej 3 orësh, qan dhe shqetësohet vazhdimisht nga uria, do të thotë se është gati të kalojë në ushqimet shtesë.

Ushqimet e para shtesë që mund t'i jepen bebes janë puding me miell orizi e qumësht, pure frutaperimesh dhe kos. Duhet të bëhet kujdes që ushqimet shtesë që i jepen bebes para 6 muajsh, të jenë në trashësinë e puresë me pak mbetje dhe pa gluten. (Gluteni gjendet te drithërat si elbi, gruri, tërshëra)

Në dy muajt e parë të fillimit të ushqimit shtesë është mirë t'i jepni bebes 600 ml. qumësht në ditë.

Problemet që hasen shpesh gjatë të ushqyerit artificial

Qumështi i nënës është një ushqim ideal për bebet në periudhën 0-6 muaj. Ky qumësht i cili e ushqen beben fizikisht dhe mendërisht, e mbron ndërkohë atë edhe nga shumë infeksione të rënda. Në vendet në zhvillim, vdekja që shfaqet lidhur me diarrenë te bebet që ushqehen vetëm me qumësht gjiri është në shkallë shumë të ulët në krahasim me bebet që ushqehen me ushqim artificial.

Edhe pneumonia e rëndë te bebet që ushqehen me qumësht gjiri është më e pakët. Në të gjithë botën diarreja, sëmundja e rrugëve të frymëmarrjes, infeksioni i veshit të mesëm shihet më shpesh te bebet që ushqehen me ushqim artificial.

Qumështi i gjirit është i gatshëm dhe në ngrohtësinë e përshtatshme në çdo kohë që e kërkon bebja. Ndërsa ushqimi artificial duhet të "përgatitet" për beben në ngrohtësinë e përshtatshme dhe sasinë e duhur. Duhet që bebes të mos i jepet ushqim i përgatitur para shumë kohësh apo të përdoret ushqim i mbetur nga një vakt, por sa herë që beben e merr uria, duhet t'i përgatitet ushqim i freskët.

Pra ushqimi artificial ka "problemin e përgatitjes". Nuk është praktik. Kjo gjendje ia vështirëson punën nënës. Te bebet që ushqehen me ushqim artificial, ngaqë tretja e tij është e vështirë, zgjat edhe koha e boshatisjes së stomakut.

Gabimet që bëhen gjatë përgatitjes së ushqimit dhe gjatë ushqyerjes së bebes mund të bëhen shkak për të vjella, sëmundje të stomakut-zorrëve, ushqyerjes së tepërt ose të pamjaftueshme, rritjes së lëndëve minerale në gjak. Nëse vrima e biberonit është shumë e vogël, bebja harxhon shumë fuqi, lodhet shpejt dhe kjo e bën të shqetësohet. Nëse është e madhe, ushqimi rrjedh shpejt dhe si rrjedhojë bëhet shkak për dhimbjen e gazrave te bebja. Durimi i dhimbjeve të gazrave, nuk është fare i lehtë.

Vetë ushqyerja e fëmijës me biberon duke ia futur atë në gojë, mund të bëhet shkak për kalimin e ushqimit në rrugët e frymëmarrjes, për zhvillimin e pashëndetshëm të nofullave dhe për prishjen e dhëmbëve, për më tepër, ndikon negativisht në zhvillimin social të fëmijës.

Përfundimisht, në ushqyerjen e fëmijës, asnjë lloj ushqimi nuk e zë vendin e qumështit të nënës i cili është përgatitur nga ana e një "Dore të Fuqishme" e të mëshirshme, në mënyrë që fëmija të rritet e të zhvillohet i shëndetshëm shpirtërisht dhe fizikisht.

Nejla Bash

A jeni gati për dimër?

Tashmë ato ditë të shkëlqyera diellore të verës dhe të vjeshtës së vitit të kaluar na lanë. Të jetuarit në vendin tonë të katër stinëve është një mirësi tjetër e Allahut Teala… Pas vjeshtës natyra sikur hyn në një heshtje vdekjeje. Gjallëria që merr sipërfaqja e tokës në pranverë ne dimër merr fund dhe vendin e saj e zë një dimër e mërzitshëm, i heshtur.

Te njerëzit ndjenja e pritjes së dimrit nuk zgjon një emocion sa kur i thonë verës "mirë se erdhe". Në fakt, çdo stinë ka bukurinë e saj. Ecja në mot të hapur e të freskët, shëtitja në kohë të hapur pa u mërzitur ka një shije krejt tjetër.

Të ndjekësh ndryshimin e ngjyrës te gjethet e pemëve ndjen kënaqësinë e madhe e të zhyturit në meditim. Sidomos nuk ka kënaqësi më të madhe se kundërmimi i tokës pas shiut, përjetimi i ndjenjës së qetësisë në të cilën ushqehet shpirti ynë në sajë të jodit që shtohet në ajër.

Me ndryshimin e stinëve ndryshojnë edhe mirësitë që paraqiten nga sofra e universit. Veçanërisht për njerëzit e fshatrave, të cilët jetojnë me natyrën, fillon një shqetësim i ëmbël për ditët e ftohta dhe të errëta të dimrit. Ky është një sezon i gjatë që fillon për të mbushur dhomat të cilat hapen dhe mbyllen me Besmele.

Tharja, skuqja, kriposja e shumë fruta-perimeve që rriten nga fundi i majit deri në fundin e tetorit, reçeli, pekmezi, salca etj., që kërkojnë mjeshtëri më vete, janë punë me rregulla dhe shumë të mundimshme. Por ata përfitojnë shumë nga kultura e të ushqyerit me fruta e perime që i përkasin vetëm dimrit dhe që i mban larg ushqimeve industriale për një dimër të tërë. Të paktën në pranverën e ardhshme tek ata nuk do të duket një nga sëmundjet e shekullit, siç është "sindroma e lodhjes së pranverës".

Përkundrazi, njerëzit e qytetit jetojnë shumë larg të mësuarit të të ushqyerit sipas stinëve, sepse me zhvillimin e teknologjisë dhe prodhimit të ushqimit industrial tashmë është bërë shumë e lehtë që gjatë gjithë vitit të gjesh çdo lloj ushqimi. Askush nuk habitet kur në mes të dimrit shikon domate, kastravecë, rrush, shalqi etj. Brezi i ri ka ardhur në atë gjendje, saqë nuk mund të ndajë frutat dhe perimet që i përkasin dimrit dhe verës.

Ndërsa nënat, ngaqë janë mësuar me rehatinë e teknologjisë dhe lehtësinë e përgatitjes së ushqimit, nuk mund ta braktisin këtë zakon. Gratë e qytetit kënaqen sidomos kur nëpër markete rastisin në çdo lloj konservash dhe produktesh të ngrira, fruta dhe perime jo të stinës, që i gjejnë me çmime të favorshme. Por këtë faturë e paguan mirësia më e madhe që na është dhënë: Shëndeti!..

Ky zakon bëhet shkak për sëmundjet e muskujve, sindromave të shekullit dhe më e rëndësishmja, shkakton shqetësime psikologjike. Për të mos u përballur me këto përfundime, ajo që duhet të bëjmë është të lodhim kokën dhe t'i anashkalojmë vështirësitë e lodhjet afatshkurtra.

KUJDESI GJATË PËRGATITJES SË USHQIMEVE TË DIMRIT

Ushqimet më të përhapura dimërore nëpër shtëpi janë salca, konserva, reçeli dhe turshia. Veçanërisht mes këtyre futet edhe veprimtaria e ngrirjes së fruta-perimeve të cilat merren në kohën e tyre, veçse kjo duhet të bëhet sipas disa rregullave. Përndryshe, në vend që të kenë dobi për shëndetin, mund ta dëmtojnë shumë atë. Mendoj se është e nevojshme që t'i kujtojmë përsëri gjërat për të cilat duhet të kihet kujdes.

1. Kavanozat që do të përdoren për konserva duhet të lahen mirë dhe kapakët e tyre prej metali duhet të ndërrohen çdo vit.

Perimet të cilat do të konservohen, nuk duhet të lihen për një kohë shumë të gjatë në ujë dhe uji më parë duhet të jetë i zier.

Në kavanoza së pari duhet të hidhet shëllira pastaj të vendosen perimet.

Në kavanoza nuk duhet të lihet shumë boshllëk, por as të mbushen plot e përplot.

Kavanozat duhet të ruhen në ambient të freskët dhe të errët. Nëse konservat mbahen në vende të nxehta, formohet një helm që quhet "botulin". Kjo toksinë formohet nga bakteri që quhet "Clostidium botilinum", që qëndron gjallë madje edhe në nxehtësinë e zierjes dhe nga shumimi i sporeve.

Meqë kjo bakterie nuk zhvillohet në ambiente me acid, në përgatitjen e konservave duhet të përzgjidhen perime që përmbajnë acid. Perimet, si lakra, patëllxhani, lulelakra, selinoja të cilat nuk përmbajnë acid, bëjnë pjesë te perimet që nuk këshillohen për konservim në shtëpi.

2. Trahanaja, kur thahet në diell, humb shumë vlera ushqimore me në krye vitaminën B2. Prandaj ajo duhet të thahet në hije ose duke e mbuluar me një copë të hollë.

3. Në përgatitjen e reçelit, turshive, salcës etj., duhet të përdoren enë prej qelqi. Nëse nuk gjenden enë qelqi, të përdoren enë plastike të miratuara nga Ministria e Bujqësisë. Këto enë duhet të përdoren vetëm një herë. Pasi të mbarojë produkti, nuk duhet të përdoren sërish.

4. Ngrirja e produkteve në frigoriferë është mënyra më e përhapur. Procesi i ngrirjes nuk i vret mikrobet, vetëm ndalon zhvillimin e tyre. Produktet që do të futen në procesin e ngrirjes nuk duhet të jenë të dëmtuara e as të zbutura. Produktet më të freskëta dhe më cilësore, pasi të lahen mirë, paketohen në porcione për ngrënie dhe ngrihen në frigorifer. Te disa perime bëhet parapërgatitja si vlimi. Procesi i vlimit bëhet për të ndaluar aktivitetin e enzimave të perimeve. Para se t'i vlojmë perimet, uji i vlimit duhet të jetë i zier dhe vlimi duhet të bëhet në 3-4 minuta, pastaj duhet të ftohen menjëherë. Asnjëherë nuk duhet të vendosen në frigorifer për ngrirje të nxehta apo të vakëta. Sa më shpejt të bëhet veprimi i vlimit, ftohjes, paketimit dhe vendosjes në frigorifer, aq më pak vlera ushqimore humbin produktet.

Kur të gatuhen perimet e ngrira, duhet të vendosen të ngrira në tenxhere. Perimet nuk duhet të zgjidhen para gatimit.

5. Metoda e ruajtjes së domateve në kavanoza: Domatet qërohen dhe kalohen në rende. (Domatet qërohen më lehtë nëse i hidhni në ujë të nxehtë) domatet e grira zihen në një tenxhere pa vaj. Pasi lëngu avullon dhe masa trashet pakëz, hiqet tenxherja nga zjarri dhe mbushen kavanozat e qelqit ndërkohë që është e nxehtë. Pa humbur kohë, mbyllen kavanozat me kapakë dhe kthehen përmbys. Mbahen përmbys të paktën një ditë. Gjatë gjithë dimrit mund t'i ruani në ambient të freskët e të errët dhe mund t'i përdorni në çdo lloj supe, salce apo ushqimi.

Përgatitja e majonezës në kushte shtëpie

Vendosen në mikser dhe përzihen një e verdhë veze e freskët, një lugë gjelle uthull rrushi, gjysmë limoni i shtrydhur, një lugë çaji kripë, një gotë uji vaj ulliri, më pak se një gotë ujë, 2 lugë gjelle niseshte dhe pak vaj.

Në anën tjetër, niseshtenë e përziejmë me ujë të ftohtë dhe ziejmë deri sa të marrë masën e një pudingu. Pastaj niseshteja përzihet me vezën me vaj që ndodhet në enën e mikserit dhe përzihet mirë. Ndërkohë që e përziejmë duke i hedhur pak nga vaji që kemi në dorë, i hedhim edhe pak uthull dhe lëng limoni për t'u hapur, pastaj pak vaj, pastaj vazhdojmë ta përziejmë duke i shtuar nga pak uthull dhe lëng limoni. Për të kuptuar trashësinë e majonezës, e vizojmë me majën e një thike. Nëse ndahet plotësisht dhe nuk bashkohet menjëherë, do të thotë se është bërë. (Për ta trashur masën, duhet t'i shtojmë vaj, ndërsa për ta holluar, i shtojmë uthull dhe lëng limoni)

Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHTIT 2005

KONSUMONI PRODUKTE ME CILËSI TË VËRTETUAR

CILËSI E VËRTETUAR

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Adresa-Address:"Tirana" N:9, Prizren
Tel & Fax: +381 29 622 356
E-mail:abi@abimilk.com

www.abimilk.com

"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës
Numri i licencës : AVUK-001
"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033